

**MENELLA TOTONI**

## **VEZHGIME RRETH SË FOLMES SË QYTETIT TË GJIROKASTRËS**

*(Fonetikë e morfologji)*

Gjirokastra është një nga qytetet e mëdhenj më jugorë të Shqipërisë. Ndodhet në të majtë të lumit Drino, i ngritur pjesërisht në shpatin shkëmbor të Malit të Gjerë dhe pjesërisht mbi disa brigje në këmbë të tij. Qyteti përshkohet nga përrenj shpesh të thellë e me brigje të thepisura, që e ndajnë atë në disa pjesë dhe i japin pamjen e një pëllëmbë ose të një gjetheje fiku. Qyteti ndahet në këto lagje: 1) Dunavat, sot quhet më tepër Dunavati Parë, 2) Dengat, sot Dunavati Ditë, 3) Gjobek, sot Teqé, 4) Palorto, 5) Çetemel, 6) Varosh, 7) Meçite, 8) Hazmurat, 9) Pazari vjetër, 10) Çfakë (dhe Fcakë), 11) Pdhakë «Pllakë», 12) Manalat i cili ndahet në Manalati Parë dhe i Ditë.

Gjirokastra rrethohet nga këto krahinëza: në veri Rrëza e Tepelenës, në lindje e juglindje Lunxheria dhe Libohova, në jug Dropulli, në jugperëndim dhe perëndim, të ndara nga Mali i Gjerë, Delvina dhe Rrëzoma, në veriperëndim Kardhiqi dhe Kurveleshi (shih hartën Nr. 1). Të gjitha këto krahinëza, me përjashtim të Rrëzonës dhe Delvinës, kanë pasur dhe kanë marrëdhënie të ngushta ekonomike me Gjirokastrën. Ajo ka qenë qendra ku fshatarët shisnin prodhimet e tyre blegtorale dhe ato pak prodhime bujqësore (sepse si vise malore merreshin pak me bujqësi) dhe ku blinin sendet e nevojshme për jetesë.

Gjirokastra bën pjesë në krahinën e Labërisë<sup>1</sup>. Gjirokastritët që merreshin me bujqësi dhe blegtori, e mbanin veten për labër, po pjesa tjetër që merrej me nëpunësira dhe tregëti, sikur s'e kishin fort për qejf emrin «lab» dhe e përdornin me mospërfillje. Nga veshja karakteristike e vendit, nga mënyra e të kënduarit dhe nga zakone të tjera Gjirokastra afrohet me Kardhiqin e Kurveleshin, që e mbajnë veten për labër.

Në kohën e sundimit turk Gjirokastra nga pikëpamja administrative varej nga Delvina. Nën administrimin e vet ajo kishte Lunxherinë, Libohovën, Dropullin dhe Kardhiqin, krahina që ndodhen në të dyja anët e lumit Drino. Pas pavarësisë Gjirokastra ka qenë qendër prefekturë dhe kishte nën administrimin e vet një zonë mjaft të madhe, që përfshinte: Konispolin, Delvinën, Sarandën me Bregdetin e Poshtëm, Kurveleshin, Tepelenën dhe Përmetin me krahinat e tij. Sot ajo është qendër rrethi dhe ka nën administrim zonën që mbyllet në lindje nga vargmali Dhëmbel-

1) Rr. Zojzi: *Ndarja krahinore e Shqipërisë* në «Etnografia shqiptare» I, 58 v.

Nemërçkë, në veri nga Mali i Picarit, në perëndim nga Mali i Gjerë dhe në jug nga kufiri shtetëror, duke përfshirë kështu veç Dropullit, Libohovës, Lunxherisë e Kardhiqit edhe Pogonin, Zagorinë, një pjesë të Rrëzës së Tepelenës dhe të Kurveleshit të Sipërm.

Qyteti i Gjirokastrës ka një popullsi prej rreth 15000 frymësh. Pjesa më e madhe e popullsisë së qytetit është myslimane, ndërsa pjesa tjetër e përqëndruar kryesisht në lagjet Varosh e Pazar i Vjetër është ortodokse. Banorët janë marrë më shumë me nëpunësi. Si të tillë në kohën e sundimit turk i gjeje jo vetëm në vilajetet e Shqipërisë, po edhe jashtë tyre. Banorët e lagjeve periferike, sidomos të Dunavatit, Manalatit e Palortosë, janë marrë edhe me blegtori e bujqësi, zanate që pjesërisht i vazhdojnë dhe sot. Këta ose punonin tokat e tyre që kishin përposh në fushën e Drinos, ose i merrnin me të tretë nga agallarët e Gjirokastrës. Pas çlirimit këtu janë ngritur disa ndërmarrje industriale, kështu që një pjesë e popullsisë e aftë për punë sot punon në to. Kjo ka një rëndësi të madhe për Gjirokastrën, sepse i ka vënë fre emigracionit.

Gjirokastra është qytet me tradita arësimore. Në kohën e pushtimit



turk ka pasur shkolla në gjuhë të huaj. Ka pasur shkollë që prej 1633<sup>2</sup>. Evlia Çelebi<sup>3</sup>, udhëtari turk që ka shetitur Shqipërinë në çerekun e fundit të shek. XVII, tregon që në këtë kohë në Gjirokastrë kishte 3 medrese, 5 shkolla fillore dhe 1 shkollë të madhe. Shkolla në gjuhë amtare u hap me 1908. Para çlirimit ka pasur një shkollë të mesme. Sot ka disa shkolla 11 vjeçare, një pedagogjike etj.

Martestat gjirokastritët i kanë bërë kryesisht brenda për brenda, midis lagjesh ose dhe në të njëjtën lagje. Nga vendet e tjera më shumë hiqej Libohova me Delvinën; në këto dhe kanë dhënë dhe kanë marrë. Nga Kardhiqi dhe fshatra të tjerë merrnin, po shumë rrallë jepnin.

Gjirokastra është qytet i vjetër, me pamje të përgjithshme të një qyteti mesjetar. Në mes të saj ngrihet kalaja, e cila është një nga më të ruajturat dhe më madhështoret në Shqipëri. Pyetjes se kur është themeluar qyteti dhe kalaja e tij nuk i është dhënë përgjigje e saktë as nga L. Dilo që është marrë me këtë çështje në veprën që u citua më lart, me sa duket për mungesë dokumentash. Sidoqoftë në mënyrë të përgjithshme mund të pohohet që ajo është themeluar para vitit 1000 të e.r. Edhe për prejardhjen e emrit Gjirokastrë (e paqartë nga pikëpamja etimologjike del pjesa e parë Gjiro-, sepse e dyta -kastër lidhet me lat. castra «kamp») ka mendime të ndryshme. Disa e lidhin me emrin e Gjin Bua Shpatës, të tjerë me emrin e princeshës Argjiro që u hodh nga muret e kështjellës për të mos rënë në duart e turqve, disa të tjerë e lidhin me argjend, sepse do të ketë pasur miniera argjendi etj.<sup>4</sup> Banorët e mbajnë veten për vendës prej kohësh që s'mbahen mend, gjithashtu ata nuk dinë të ketë patur lëvizje të mëdha të popullsisë sidomos imigrime. Po, sidoqoftë, duke qenë një vend malor e i varfër, me kushte jo të kënaqshme jetese, familje të veçuara kanë qenë të detyruara të emigrojnë. Ky emigracion ka qenë i madh pas pavarësisë, po sidomos pas çlirimit. Gjirokastritë gjen shumë në Fier, Vlorë e Tiranë. Imigrimet nga krahinat përreth kanë qenë të paka dhe të veçuara, prandaj edhe s'kanë lënë gjurmë.

\* \* \*

Në këtë punim studiohet e folmja e Gjirokastrës kryesisht në gjendjen e saj të ruajtur. Për arsye të kohës së shkurtër nuk kam mundur të mbledh materiale për të gjitha çështjet në të gjithë brezat, duke i ndarë ata edhe sipas gradës së kulturës. E parë pra në këtë anë kjo e folme paraqitet e njëjtë. Nuk vrehen ndryshime të rëndësishme midis lagjeve dhe popullsisë me fe myslimane dhe ortodokse. Ndryshime më shumë vrehen midis brezave, sidomos midis brezit të vjetër e të mesëm, nga një anë, dhe të riut, nga ana tjetër, si edhe në të folmen e njerëzve të padalë e analfabetë dhe atyre të dalë e të shkolluar.

\* \* \*

Kjo e folme karakterizohet nga një sërë tiparesh dialektore, që i japin një fizionomi të vetën, të dalluar mirë nga të folmet që e rrethojnë.

2) L. Dilo: *Gjirokastra nëpër shekuj* (kopje e daktilografuar pranë Arkivit të Inst. të Hist. e Gjuh.), 31.

3) E. Çelebi: *Shqipëria para dy shekujsh* përkthyer nga libri turqisht, *Evliya Çelebija Sejjatnamesi* prej S. Vuçiternit, Tiranë, 1930.

4) Shih për këtë L. Dilo, *vep. e cit.*, 4 v.

Me këtë ose atë të folme ka mjaft tipare që e afrojnë, po njëkohësisht ka dhe mjaft të tjera që e largojnë. Nga kjo pikëpamje afër i qëndrojnë të folmet e Lunxherisë dhe të Kardhiqit, po sidomos ato të krahinës së Libohovës dhe të Delvinës (qytet). Këto dy të fundit formojnë me të folmen e Gjirokastrës një njësi, e cila, me sa duket, është ndërtuar mbi bazën e marrëdhënieve martesore midis këtyre tri vendeve dhe karakterizohet nga disa tipare mjaft specifike, që e dallojnë nga të folmet përreth. Këto tipare janë: 1) ruajtja e ë-së fundore në fjalët paroksite: *bukë*, *shtëpisë* etj.. (kjo ë ruhet edhe në Lunxheri e Zagori), 2) ndrimi i ll-së në *dh*, *didhë* «dyllë», *dhadhë* «dhallë» etj., 3) mungesa e dridhëzës *rr* : *rush*, *ndroj* etj. (kjo nuk ndihet as në Lunxheri), 4) gjallëria mjaft e madhe e mbaresës -e të shumës të emrave mashkullorë, 5) përdorimi i nyjës së përparme së në vend të nyjës të të rasës gjindore, dhanore e rrjedhore: robat e atija së vdekurit /, i thotë së gjadhrit / (këtu afrohen veç së folmes së Lunxherisë përërisht edhe të folmet e Kardhiqit e të Rrëzomës së Delvinës, 6) në sintaksë: përgjithësimi i ambigjenisë në shumësin e emrave mashkullorë që emërtojnë jofrymorë, me mbaresat -e dhe -ra.

\*   \*   \*

Nga M. Lambertzi sot kemi një studim<sup>5</sup> për të folmen e Gjirokastrës sipas materialit gjuhësor të nxjerrë nga libri i M. Kokolarit «Siç më thotë nënua plakë» (Tiranë, 1944). Në këtë studim janë trajtuar disa probleme të fonetikës si: ruajtja e l-së së vjetër, ndrimet *dh* : *ll* e *ll* : *dh*, *y* : *i e u*, *rr* : *r*. Më gjerë është trajtuar morfologjia, po pjesën më të madhe të punimit prej gati 60 fq. e zë studimi për leksikun dhe stilistikën gjuhësore. Aty këtu ka dhe ndonjë vrejte për sintaksën. Studimi në fjalë ka karakter përshkruar. Materiali mbi të cilin është ngritur ky punim, nuk reflekton besnikërisht të folmen e Gjirokastrës në gjendjen e ruajtur të saj. Nga pikëpamja fonetike e morfologjike gjuha e atij libri përfaqëson të folmen e një intelektualit nga Gjirokastra, të larguar prej kohësh e me ndjenjë dialektore të lëkundur. Kështu ndrimi *dh* : *ll* nuk vrehet në të folmen e brezit të vjetër, trajta me *nj* të së pakryerës si *prishnja* nuk ndihen në Gjirokastrë etj. E ndikuar nga gjuha e përbashkët e shkruar gjirokastricja e këtij libri paraqitet me një përdorim të rëndomtë të disa trajtave që në të folmen e gjallë janë të kufizuara. Për këto arsye ky material nuk është përdorur në këtë punim, po ai është pasur parasysh si orientim gjatë mbledhjes së materialit. Si rrjedhim dhe punimi i M. Lambertzit në fonetikë e morfologji reflekton të metat e materialit ku është mbështetur.

Të dhëna gjuhësore të veçuara nga kjo e folme gjejmë edhe në punimet e E. Çabejt, i cili veç kësaj më ka kumtuar gojarisht edhe fakte të tjera gjuhësore, që më kanë ndihmuar në saktësimin e ndonjë fenomeni.

Materiali për këtë punim është mbledhur gjatë një ekspedite prej 13 ditësh në Gjirokastrë më 1963, nga persona të brezit të vjetër e të mesëm, kryesisht të padalë e analfabetë. Emrat e personave të brezit të

5) M. Lambertz: *Zur albanischen Umgangssprache* në «Linguo Posnaniensis», Vol. VII, 1958, 85 — 144.

ri, përveç njerit, nuk janë dhënë këtu, sepse prej tyre janë mbledhur materiale sa për të parë zhvillimin e ndonjë fenomeni të veçantë<sup>6</sup>.

Metoda e mbledhjes së materialit ka qenë biseda e lirë dhe pyetja e tërthortë.

Ky punim synon të kapë, të përshkruajë e të shpjegojë, kur ka mundësi, tiparet dhe fenomenet fonetike dhe morfologjike më specifike të kësaj së folmeje. Disa nga këto çështje janë parë më gjerë dhe është përcaktuar shtrirja gjeografike e tyre, e cila në ndonjë rast është konkretizuar me hartë. Të dhënat për të folmet e tjera i kam mbledhur vetë gjatë ekspeditave prej 1959 e këtej. Një pjesë e këtyre materialeve janë botuar në punimet e mëparshme të mijat, pjesa tjetër ndodhet në kartotekën e sektorit.

## FONETIKA

### Theksi

1. Për sa u përket fjalëve të huajtura nga turqishtja dhe greqishtja kjo e folme më shumë se të folmet e tjera të toskërishtes ruan theksin e fjalës së gjuhës nga është huajtur. Kështu ndihen të theksuara në rrokjen fundore: *dishemé, çilté, Hajrijé, mezé, qofté, qoshé, zhezvé, paçá, pará, bakër* etj., gjithashtu: *bojá, boshtá, futá, jaká, hujá, ková, mashá, odá, sufrá, trahaná*, të cilat në të folme të tjera paraqiten jo vetëm me theks të çvendosur në rrokjen e parë, po dhe me zanoren fundore të reduktuar: *bojë, boçë, futë, jakë, kovë, mashë, odë, sufër, trahan*. Kjo prirje e kësaj së folmeje për të mos e çvendosur theksin e fjalëve turke nuk vrehet në fjalët penxhere e tenxhere. Këto dalin edhe të theksuara në rrokjen e dytë: *penxhére, tenxhére*, po më shumë në një trajtë të reduktuar me theks në rrokjen e parë: *pénxhre, ténxhre*.

Edhe në fjalët e huajtura nga greqishtja: *kókadh, kondó, piperjé, záhar*, theksi nuk ka ndruar vend në krahasim me fjalën greke. Fjalët turke *mándadh* dhe *távan* me theks në rrokjen e parë, duket që kanë hyrë në këtë të folme nëpërmjet greqishtes, sepse reflektojnë trajtën greke *μάνδαλος* dhe *τάβανος*.

Për t'u vënë në dukje është edhe theksimi në fjalët *gócha, qúfura* (krh. *goxhá, qyfýre*).

6) Këta persona janë:

Dunavat: 1) *Nesibe Karagjozi* vj. 80, 2) *Elma Rusto* vj. 75, 3) *Sali Fico* vj. 78, 4) *Siri Brahimi* vj. 31, ka 3 kl. fillore, bari.

Munalat: 5) *Hajrije Majko* vj. 105, 7) *Safie Shehu* vj. 57.

Palorto: 8) *Tate Sherifi* vj. 66, bari, 9) *Muharrem Gjoksi* vj. 59, bari, ka ndenjor dy vjet në Korçë.

Teqe: 10) *Zyrhe Mehmetaj* vj. 92, ka ndenjor 2 vjet në Durrës, 11) *Fejme Shehu* rreth vj. 55.

Pazar i Vjetër: 12) *Vasil Muka* vj. 83.

Varosh: 13) *Melia Njoçka* vj. 70, 14) *Melpo Zëri* vj. 50.

Hazmurat: 15) *Neuro Alikaj* vj. 53.

Material për plotësim e saktësim është mbledhur edhe nga gjirokastritë që banojnë në Tiranë, si *Faikat Qosaj* vj. 60 dhe *Hatixhe Kadareja* vj. 52. Me këtë rast falnderoj të gjithë personat e përmendur për gatishmërinë dhe ndihmën që më kanë dhënë.

## Zanoret

2.- Zanorja e e theksuar para një nazaleje të temës është shndruar në ë, tingull i njëjtë me ë-në që është përshkruar nga A. Dodi<sup>7</sup>. Për nga shqyptimi dallohet prej tingullit ë që ndihet në disa fjalë në Kurvelesh e Bregdet e në ndonjë zonë tjetër të Labërisë si edhe në Zagori<sup>8</sup> dhe është i njëjtë me atë që shqiptohet në Delvinë (qytet), Vlorë (qytet), Përmet, Leskovik e Kolonjë: *brënda, i çmëndur, drënjë, dhën, ëmër, e ënjte, fëmër, gjëndje, gjëmb, mbrëmë, parmëndë, pëndë, qënë, shkencë, trembem, vënë, e bardhërëme* etj. Ky fenomen (e : ë) vërtetohet sot dhe në ato raste kur nazalja *nj* është shndruar në *j* si : *ndëjtur* (<ndënjtur) etj., ose kur *n* është rotacizuar si: *frëri* etj., si dhe në rastet kur nazalja *n* në mes të fjalës ose në fund të saj ka rënë: *frë, vësht* etj.

2.1. Në pak fjalë në vend të ë-së që pritej, kemi *e*: *Golém, i rëm* «i rrem», *qënjgj, qër-i, préhem*. Është për t'u vënë në dukje që si në Përmet e Leskovik këto fjalë janë në një numër të kufizuar, pak a shumë fjalët e mësipërme, dhe që kjo *e* psh. në fjalën *qeri* nga pikëpamja fonetike nuk ndryshon nga *e*-ja në fjalën *qere*-ja.

2.2. Në ndonjë rast ë e theksuar para një nazaleje ka dhenë *i* si *int* (<ënt<end), *linde* (<lënde).

2.3. Në disa fjalë si *flë, gjëpura, ndër, ngrë, plëhë* vrehet një shndrim analogjik i *e*-së në ë, sepse në këto fjalë *e*-ja nuk ndodhet dhe nuk është ndodhur para ndonjë nazaleje.

3. Zanorja ë e theksuar e toskërishtes, me përjashtim të disa fjalëve, nuk ka pësuar ndonjë ndryshim: *dëm, dhëndër, ëngjëdh, t'ëmbël, hënëzë, gjëndër, lëng, lënë, lëmsh, mëngë, ngrënë, rënë, tënd, bëj, gërshërë, gjëlpërë, të tërë, thëdhëzë* «thëllëzë», *e vrërët, shudhë* «shullë», *pë* etj. Nga pikëpamja fonetike ky tingull është i njëjtë me ë-në, për të cilën u fol në pikën 2.

3.1. Në pak fjalë kjo ë, si dhe ë-ja që vjen nga një *e* para nazaleve, ka dhënë *e*: *i gjërë, i krishtër, njëri, njëra, qen*. Duket se janë ndikime të vona të anës së Kurveleshit trajtat me ë të këtyre fjalëve, që ndihen më të rrallë dhe më tepër në brezin e mesëm e të riun, si : *i gjërë, qën*.

3.2. Historikisht kjo ë, siç është vënë re prej kohësh, vjen nga një *a* e theksuar para një nazaleje, fenomen që ka filluar që para rotacizmit dhe në disa të folme ka vazhduar edhe shumë kohë pas tij, siç në dëshmojnë shumë fjalë të huajtura nga turqishtja e greqishtja. Në këtë të folme, me sa duket, fenomeni më pas nuk ka qenë aq aktiv, sepse nuk ka prekur fjalë të tilla si: *man, pishman, kadham, tamam* etj.

3.2.1. Nga ana tjetër këtu është ruajtur zanorja *a* edhe në fjalë të tilla si : *hangri, amni* «sa t ipni, amni», *nam, ajtur* «t ajtet dora», *vath e gjakundi*, fenomen i kufizuar në teritor (haset edhe në Labovën e Kryqit (Libohovë) dhe i shtrirë në një numër të kufizuar fjalësh, — këto në mos qofshin të vetmet, të tjerat duhet të jenë shumë të paka.

4. E folmja e Gjirokastrës është ndër ato të folme të pakta, që në formën e tyre të ruajtur e shqiptojnë, dhe bile jo rrallë, ë-në e patheksuar fundore në fjalët proparoksitone ose dhe në fjalë katërrokëse me theks mbi rrokjen<sup>9</sup> e parë si : *fëndëratë, ëmëritë* etj. Në ruajtjen e ë-së në këto raste lot rol ritmi i të folurit, po sidoqoftë edhe disa faktorë të

7) A. Dodi: *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe* Tiranë 1963, f.60vv.

8) Shih M. Totoni: *E folmja e Kurveleshit* (i pabotuar); *E folmja e Bregdetit të Poshtëm*, Stud.Filol. 1964, Nr. 1, 136; *E folmja e Zagorisë*, Bul. U.Sh.T. 1962, Nr. 1, 184.

tjerë nuk duken pa rëndësi. Kështu ruhet shpesh herë ë-ja fundore në fjalët që kanë në rrënjë togjet zanore *ua* dhe *ie*: *dúadhnë, dúadhë, fúalë, liejmë, shíeshmë, míedhtë, míedhë* etj.; në trajtën e rasës kallzore të emrave: *t'ënjtenë, kóshtinë, nënënë, zëmrënë, núsenë, púlënë*, si dhe në fjalët katërrrokëse me theks në të dytën: *lëkúrënë, sahátinë, doktórinë, Hisénjinë* etj.; në trajtat e së pakryerës të diatezës pësore, mesore: *trëmbeshmë, bëneshnë, mblídheshnë, hídheshnë* etj.; në më pak raste ruhet ë-ja fundore në trajtën e emërores shumë: *mbésatë, krúshqitë, këmbëtë dhe hajdútëtë* etj.; më në fund ë-ja fundore ndihet shpesh edhe në prapashtesën -(ë)lë: *lidhëllë, mésëllë, rójtëllë, vrásëllë, dájkëllë, Hámzëllë, Súlëllë, Dhímëllë* etj.

Në trajtat e shumësit të së tashmes dhe së pakryerës të foljeve më bashkëtingëllore, në vetën e I njëjës të së pakryerës të po këtyre foljeve, në trajtat e pjesores me *-ur, -uar, -ier* ë-ja fundore thuhet nuk ndihet: *hëqim, sapunísim, vjelím* etj., *lidhim, shitim, mirim* etj., *shihij, qépij, drídhij* etj., *kudhotur* «kullotur», *haritur, haruar, takuar* etj.

4.1. Në pozicion fundor në fjalët paroksite rënia e ë-së është e rrallë dhe varet nga ritmi i të folurit. Në një të folur të shpejtë ajo ose ndihet mjaft e reduktuar ose nuk ndihet fare. Kjo ngjet më tepër kur fjala ndodhet në fund të sintagmës, po edhe në mes të saj, kur dy fjalë shqiptohen me një pauzë shumë të vogël në mes tyre: *i shpij / ku kish hej //*, *i thritim për dark //*, një dhoi është //, këtu është ler e ritur //, është bën bostanxhi // etj. Kur nyja ose pjesëza të vjen pas një fjale që mbaron me zanore, sidomos pas fjalëve njërrrokëse: *na, që, le, po, zakonisht* nuk ndihet ë-ja, kurse *t-ja* shqiptohet me fjalën që e paraprind: *na t shtëpisë vijne //*, *që t na hapi oreksin //*, *le t na e marë //*, po t jeç për baxho // etj.

4.2. Ruhet pa lëkundje si në brezin e vjetër dhe në të mesmin ë-ja semipostonike qoftë në rrokje të mbyllur si *kakërdhi*, qoftë në rrokje të hapur: *bagëti, çallëstis, erësilë, kupëton, pleqësi, burëri, çobanëri, dimëror, pleqëri, ulërij* etj.

4.3. Pak më ndryshe qëndron puna e ë-së semiprotonike dhe e ë-së në rrokjen e parafundit në fjalët katër-e pesërrrokëse me theks përkatësisht në rrokjen e dytë e të tretë. Ajo ruhet përgjithësisht mirë në të gjitha brezat në fjalët me prapashtesat: *-ës, -ëz, -ët* (emra, mbiemra) dhe në trajtën e gjindore-dhanores shumë të emrave etj. që në shumë dalin me *-ë*: *lúgësi, shtírësin, qélbësi, shpátëza, njérëzit, të frëskëta, të lárqëta, ofícëréve, misafírëvet, lúgëve, këpúcëve, blétëvet, së gjithëvet* etj., po ndonjë herë dhe *njërëzit*.

Në trajtën e shquar të emrave e mbiemrave, që mbarojnë me *-ël*, në shumësin me *-ëre* të emrave mashkullorë, në shumësin me *-ra* të emrave femërorë që mbarojnë me *-ë*, si dhe në trajtën e shquar shumë të emrave që e bëjnë shumësin me *-ër*, ë-ja semiprotonike ruhet më mirë në brezin e vjetër: *plásëla, bárkëla, shëshëla, dhérpëla, Vasílëla* etj., *drunjëre, qiftëre, kécëre, brucëra, balgëra, dasmëra, erëra, gjëmëra, kroçërit, vëdhëmërit* «vëllam» etj., po ka filluar të lëkundet në brezin e mesëm: *t ëmbli, Qakla, drapre, viçre, pronjre* etj.

Për sa u përket emrave që mbarojnë me *-ër* në emërore njëjës, midis së folmes së brezit të vjetër dhe brezave të tjerë ndryshimi është më i madh. Në të folmen e brezit të vjetër një pjesë e këtyre emrave që sot dalin me *-ër*, mbarojnë me *-rë*, duke na reflektuar kështu një trajtë me të moçme se kjo e sotmja. Dalin me *-ër* ata emra ku ë-ja reflekton një tingull origjinar si: *frashër* nga lat. *fraxinus* (Meyer 111), *gjarpër, bre-*

shë, *dimër*, ku rotacizimi i *n*-së (krahaso geg. *gjarpën*, breshën, dimën) tregon që ë-ja reflekton një tingull origjinar, *gjëndërë* nga it. *glandula* (Meyer 140), *qepër* nga lat. *caper* (Meyer 223), gjithashtu *ëndër*, *dhëndër* etj. Këta emra në të folmen e brezit të vjetër e në shumicën e rasteve në atë të brezit të mesëm në trajtën e shquar e ruajnë ë-në: *frashëri*, *gjarpëri*, *breshëri*, *dimëri*, *gjëndëra*, *qepëra*, *ëndëra*, *dhëndëri* etj.

Dalin me -rë: *kuçedrë* nga lat. *chersydrus* (G. Meyer, Indogerm. Forcshungen 6,107), *kulloshtrë* nga lat. *cōlostra*, *ksistrë* nga gr. e re *ξύστρα* (Meyer 208), *kanistrë* nga gr. e re *κανίστρα* (Meyer 174), *kapistrë* nga gr. e re *καπίστρι* (Meyer 175), *petavrë* nga tr. *pedavra* (Meyer 330), *vedrë* nga bullg *vêdro* (Meyer 465), gjithashtu *mitrë*, *motrë*, *bushtrë*, *vatrë*. Siç dëshmon fjala *lundrë* nga lat. *lunter* (Meyer 251) e ndonjë tjetër, duket që më parë në këtë të folme ka pasur një prirje të kundërt nga kjo e sotmja, që ë-ja të kalonte nga para *r*-së pas saj.

Kështu paraqitet ky fenomen edhe në të folme të tjera, që e ruajnë ë-në fundore si në Muzinë, Vuno, Përmet etj. Afërsisht një pamje të tillë duhet të kemi pasur edhe për gegërishten në një fazë më të moçme, gjë që e vërteton edhe Buzuku: *vepërë*<sup>9</sup> LVI/2a nga lat. *opera* (Meyer 466), *vepëra* XLIIIA, *vepëratë* XLVII/2a dhe *vedrë* XXXVIIIb.

Në të folmet e shqipës, që e kanë humbur ë-në fundore (këtu përfshihen të gjitha të folmet e gegërishtes dhe një pjesë e mirë e atyre të toskërishtes), në fjalët e tipit *vatrë*, *vedrë* para *r*-së u zhvillua një ë për të lehtësuar shqiptimin e grupit: bashkëtingëllore + *r*; kështu lindi trajta me -ër e këtyre fjalëve, që sot është bërë letrare. Ky fenomen është më i vjetër për gegërishten, po më i ri për toskërishten, meqë ë-ja fundore në këto raste ka rënë më herët në gegërishte.

Nën ndikimin e të folmeve që e rrethojnë, e sidomos nën ndikimin e gjuhës së shkruar, edhe në Gjirokastër në të folmen e brezit të mesëm është përgjithësuar trajta me -ër: *kanistër*, *kapistër*, *petavër*, *vatër*, *vedër*, *mitër*, *motër*, *bushtër*, *kulloshtër* etj. Pastaj kjo ë si edhe në emrat e tipit *gjarpër-gjarpëri* filloi të çfaqet, megjithse rrallë, edhe në trajtën e shquar: *ksistëra*, *kanistëra* etj. Gjithashtu po nën ndikimin e gjuhës së shkruar ka filluar të bjerë shpesh në të folmen e brezit të mesëm edhe në fjalët e grupit të parë: *dimri*, *drapri*, *qepra* etj., kështu që sot në këtë të folme dhe pothuajse në të gjitha të folmet e toskërishtes në lidhje me këtë çështje ka një pështjellim të madh.

4.3.1. Në rastet e rënies së ë-së pastheksore duhet përmendur dhe rënia e ë-së para *n*-së në rasën kallzore të emrave, kur pas saj vjen një emër në gjindore; nyja e përparme shqiptohet bashkë me mbaresën -*n* duke formuar një rrokje më të: *ditn e bojásë*, *djaln e xhaxhajt*, e *vrau biln e vëdhajt*, *Shkadhn e Qarit* etj.

4.4. Në rrënjë të fjalës në rrokje të mbyllur ë-ja paratheksore është ruajtur mirë: *ndërtoj*, *vërtet*, *gërnjare*, e *mërkurë* etj.

Ajo përgjithësisht është ruajtur edhe në rrokje të hapur: *dëftoj*, *gënej*, *gëzoj*, *gëshërë*, *këcej*, *fëmilë*, *këput*, *këmishë*, *shpëtoj*, *shëdhirë* «shëllirë», *tëhu* etj. Po kur ndodhet para një *r*-je që ndiqet nga një zanore, ë-ja ka një prirje të theksuar të bjerë: *ndroj*, *krej*, *thres*, *thrime*, *bruc*, *krabë*, *krutë*, *pradhë* «përrallë», *prua*, *stradh* «stërrall» etj. Nga ana dialektore ky fenomen nuk paraqitet i kufizuar; haset përgjithësisht në të folmet që nuk e kanë fonemën *rr*, si në atë të Delvinës, Muzinës, Përmetit, Leskovikut, Korçës etj. Po të kemi parasysh që ky fenomen

9) Cituar sipas transkribimit të E. Çabejt

vrehet dhe në mjaft fjalë që në formën pa *ë* janë përgjithësuar në mbarë toskërishten e në disa raste edhe në mbarë shqipen, si: *ndryshk* të cilën E. Çabej e nxjerr nga *dryshk* e këtë nga *dë+ryshk*<sup>10</sup>; *drejt* nga lat. *directus*, te Buzuku XVI/2 të *dërejtë*, Budi DC5 *dërejt*<sup>11</sup>; *mbret* nga lat. *imperator*, e cila te Kavalioti, Mitkua 184, Pedersen 156 del *mbëret*; *mrekulli*, nga lat. *miraculum*, te Buzuku XLII/2 *mërekullinë*, Budi DC 11 *mërekullij*; *prapë* që te Buzuku LV/2 del *e përhapë*; *prier* (prora) të cilën Meyeri e nxjerr nga *për+jer* e që Kavalioti e ka të *përrjel*, arb. e Greqisë të *përjer*; *pres* (preva) te Buzuku LV/2 ki *përeu* një vesh; *shprej* e *shpresë* nga lat. *sperare*, te Buzuku LXXXV/2 *shpënesënë*, Budi DC. 5 *shpëresë*; *shpretkë* nga lat. *spleneticum*, te Bardhi *shpënetëka*; *vrer* nga lat. *venenum*, te Budi SC367 *vënerizë*; *vresht*, te Buzuku (LXL/2 *vëneshtë*, Budi RR. 206 *vëneshtëvet*, gjithashtu te Buzuku XXVI *prashtu* (= për ashtu), *prarësye* (për arësye), Bogdani I, 93,27 *prashtu* etj. del që rënia e *ë-së* në këto raste si prirje është mjaft e lashtë dhe që në një periudhë më të hershme të shqipes përshkonte edhe gegërishten. Kjo prirje duhet kuptuar kështu: që *ë-ja* e patheksuar në rrënjë të fjalës bie më parë dhe më shpesh para *r-së* që ndiqet nga një zanore, se sa në rastet kur ndiqet nga ndonjë bashkëtingëllore tjetër. Arësyeja më duket që është mundësia e shqiptimit lehtësisht e grupeve tingëllore: një ose dy bashkëtingëllore + *r* + zanore, të cilët janë mjaft të rëndomtë në shqipen. Fakti që në fjalë të tilla si *mëri*, *mërej* e sidomos në formimet me prapashtesa si: *dëshëroj*, *nusëri*, *djalëri* etj. ruhet *ë-ja*, nuk sjell ndonjë pështjellim këtu, po të kemi parasysh vjetërsinë e fjalës, p.sh. *pëftreshë* (Përmet) dhe *priftëreshë*, dhe faktin që grupet bashkëtingëllorë prej dy sonantesh shqiptohen më me vështirësi. Kjo besoj është arësyeja që në shumë të folme të toskërishtes midis grupit *m-r* lind një *b* si tingull kalimtar, p.sh. në *mbrete* (Piqeras, mëret — Përmet = mret), *mbrekulli* etj. kur bie *ë-ja*.

Tani po të shohim si na paraqiten fjalët e tipit *ndroj*, *prua* etj. në të folmet e tjera të toskërishtes jugore, del që përgjithësisht atje ku shqiptohet fonema *rr* (Kurvelesh, Bregdet etj.), ruhet *ë-ja*: *bërrul*, *dërras*, *ndërroj*, *ngatërroj*, *kërrut*, *vërri*, *thërres*, *kërrab*, *përralle*, *përrua* etj. E vetmja arësye që ndikon në ruajtjen e *ë-së*, besoj është bashkëtingëllorja *rr*, e cila në këto fjalë artikullohet me më shumë dridhje se dhe në gegërishte, ku *rr-ja* sot ndodhet pas një bashkëtingëlloreje. Kjo arësye bëhet më e qartë, po të kemi parasysh që në këto anë para një *rr-je* të tillë del një *ë* dhe atje ku s'ka qenë historikisht, si: *kërrimb*, *dërrudhe* të cilën E. Çabej<sup>12</sup> e nxjerr nga një drus-dhë.

4.5 Si rezultat asimilimesh progresive dhe regresive dhe në disa raste për shkaqe të padukshme një *ë* e patheksuar ka dhënë *u*: *bukuvale*, *huqumet*, *kuputoj*, *kuput*, *kuvundoj*, *kushuri*, *nuku*, *nusuroj*, *qumusht*, *qumushtor*, *ulurij*, *umur* «ymër»; *pudhumb* «pëllumb», *sunduk*, *shtudhungë* «shtëllungë», *u zburdhul* «u zbërdhul = u zbardh», *kulish* «këlysh», *kumborë*, *mushtjerë*, *mumuligë* «mëmëligë», *supatë*. Ky fenomen, megjithse këtu paraqitet më aktiv në krahasim me të folmet e tjera përreth, nuk është përgjithësuar në të gjitha rastet. Kështu disa fjalë që në të folme

10) E. Çabej: *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe* në «Studime Filologjike» 1964, 4, 93.

11) Fjalët që vijojnë, janë cituar sipas E. Çabejt në artikullin *Për historinë e zanores ë në gjuhën shqipe*, botuar në B. I. të SH. 1955, 1, 123-146.

12) E. Çabej: *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe* në «Bul. e U.Sh.T.» 1961, 3, 63 v.

të tjera dalin me *u*, këtu dalin me *ë*: *mërzejnë, këpucë, gërmaz, mënoj* etj., nga ana tjetër një pjesë e fjalëve të përmendura më lart hasen edhe në trajtën me *ë*: *qumësht, ulërij, sënduk, nukë, bukëvale*.

4.6. Në pak raste të tjera për shkak të karakterit palatal të bashkëtingëllores që ka pranë, një *ë* e patheksuar në rrënjë të fjalës ka dhënë *i*: *bilur* «bërrul» *glibazë* «gëlbazë», *qindis, thingjidh* «thëngjill». Edhe ky fenomen paraqitet i kufizuar; në fjalë të tilla si: *gjëlpërë, lëkurë* nuk vërtetohet.

5. E folmja e Gjirokastrës nuk e ka fonemën *y*. Ky tipar mjaft i dukshëm e afron me grupin jugor të të folmeve të trevës në të majtë të Vjosës dhe e dallon nga e folmja e Kurveleshit të Sipërm e të folme të tjera në veri. Në këtë pikë të folmet e kësaj treve ndahen në dy grupe: veriori që e ka fonemën *y*, dhe jugori që nuk e ka. Kufiri midis tyre kalon nga lindja në perëndim duke lënë në pjesën jugore Vunonë, Kuçin bashkë me Çorrajn e Fterën të Kurveleshit të Poshtëm, krahinën e Kardhiqit dhe atë të Lunxherisë (shih hartën).



Ky problem paraqitet pak më i thjeshtë në grupin verior të të folmeve, po përkundrazi del mjaft i ngatërruar në grupin jugor. A e kanë

pasur ndonjëherë *y*-në këto të folme? Të paktën që nga shek. i XIV e XV, kohë gjatë së cilës u shpërngulën arbëreshët e Greqisë e Italisë, këto nuk e kanë pasur, sepse, po ta kishin pasur, ajo do të ruhej në të folmet e arbëreshëve, të cilat i kanë qëndruar larg zhvillimit që ka pësuar gjuha në Shqipëri. Problemi del i paqartë për një periudhë më të lashtë. Këtu kërkon spjegim kalimi i një *ū*-je indoeuropiane ose latine në *i*. Ndryshe qëndron puna me fjalët turke dhe me tingujt me të cilët ndrohet *y*-ja e tyre në këto të folme. Për këtë arsye problemi këtu do të shtrohet në këto dy anë: çfarë tingujsh i përgjigjen në këtë të folme e përgjithësisht në grupin jugor të të folmeve të toskërishtes jugore tingullit *y* të toskërishtes së shkruar në fjalët me gurrë të vendit e me origjinë latine e neolatine dhe me çfarë tingujsh reflektohet *y*-ja e fjalëve turke.

Në kategorinë e parë të fjalëve *y*-së në të folmen e Gjirokastrës i përgjigjet një *i* ose *u* ose dhe njera dhe tjetra: a) *il* «yll», *indirë*, *isht*, *di*, *fit*, *frij*, *hij*, *grikë*, *i grinjë*, *gjiq*, *mbidh*, «mbyll», *mbit*, *ki*, *si*, *shtij*, *shtip*, *tim*, *kulish* «këlysh»; b) *bilur* «bërryl», *dadhandushe*, *gjukoj*, *gjukatës*, *shutë*, *qutet*, *qutetar*, *deturë*; c) *atire*, *këtire*, *i tire* dhe *ature*, *këture*, *i ture*, *zirë* dhe *zurë*, *natirisht* dhe *naturë*.

Po ta shohim se si na paraqitet kjo gjendje në të folme të tjera të zonës pa *y*, del që me të folmen e Gjirokastrës më afër qëndrojnë të folmet e Libohovës, Delvinës dhe Konispolit, ndërsa më larg ajo e Lunxherisë, e Bregdetit dhe ajo pjesë e Kurveleshit të Poshtëm që hyn në këtë zonë. Puna është se sa dhe cilat fjalë dalin me *u* në këto të folme. Sikurse del edhe nga paraqitja që *u* bë më lart për të folmen e Gjirokastrës, fjalët me *u* janë më të pakta se ato me *i* dhe më të pakta janë ato në të folme të tjera. Kështu në Labovën e Kryqit dhe Nepravishtë (Libohovë) kemi: *ature*, *këture*, *i ture*, *shutë*, po *detirim*, në Delvinë: *ature*, *e ture*, *gjukoj*, *qutet* po edhe *qitetar*; në Konispol: *ature*, *këture*, *shut*, *tallandushe*, *qutet*, po *detiroj*. Në Tatzat (Rrëzomë) haset më shumë trajta me *i* e fjalëve *atire*, *këtire*, po edhe *këture*, gjithashtu *gjukoj*, *Muzeqe*, po *qitet*. Në Fushëbardhë (Kardhiq) përdoret: *atire*, *këtire*, *di*, po edhe «*nja du a tre /*», *gjush*, *bërrul*. Në të folmet e tjera dalin me *i* fjalët: *atire*, *këtire*, *i tire*, *shit-a*, *natir(-ë)*, *natirisht*, *detir(ë)*, *zir(ë)*, po përgjithërisht *gjukoj*, *gjukatës*, gjithashtu në Borsh: *dallandushe*, *brrul*, Vuno: *undirë*.

Po të kemi parasysh që *y*-ja e fjalëve të hyra vonë në këtë të folme, ose që hyjnë edhe sot, reflektohet me *i* si: *fitirë* (përdoret vetëm nga të shkolluarit), *biro* «byro» etj., del e pamundur që *u*-ja në fjalët e përmendura më lart të jetë reflektim i një *y*-je. Në disa nga këto fjalë si: *mbill*, *shtip* etj., *i*-ja është primare, kurse *y*-ja labializim i kësaj *i*-je, kështu që e folmja e Gjirokastrës e të tjerat duket që ruajnë një trajtë të parë. Për disa të tjera E. Çabej në «Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe» ka vërtetuar se në *bilur* e *brrul* (B.U.SH. 1960, 4,55), *dallandushe* (B.U.SH. 1961, 1,81), *deturë* (B.U.SH. 1961, 2, 51) dhe *shutë* («Revistë shkencore e Inst. Ped. Dyvj. të Shkodrës, 1964, 1,18) *u*-ja është primare, ndërsa *y*-ja palatalizim i kësaj *u*-je. Ndoshta një gjë e tillë mund të thuhet edhe për *u*-në në fjalët *ature*, *këture*, *e ture*, po kjo nuk mund të jetë e sigurt për sa kohë që etimologjia nuk mban një qëndrim të prerë. Fjala *naturë*, që haset vetëm në intelektualët, reflekton ital. *natura* (Meyer 298). Në fjalët *gjukoj* (nga lat. *iudicare*) dhe *gjukatës* reflektohet një *u* e shkurtër e patheksuar latine. Në *qutet* (nga lat. *civitatem*) e *qutetar*, sipas E. Çabejt (B.U.SH. 1962, 3,70-1 dhe Stud. F. 1965, 3, 45-6), *u*-ja vjen nga një *ë*, e cila është reflektim i tingullit *i* të patheksuar të latinishtes. Trajtat me *i* të këtyre fjalëve si: *atire*, *këtire*, *i tire*, *natirisht*, *zirë*, gjithashtu në të

folme të tjera *qitet*, *qitetar*, reflektojnë një formë me *y*, kështu që duhet menduar që ato janë më të vonëta dhe ndikime të të folmeve të tjera që e kanë fonemën *y*, në ndonjë rast dhe të gjuhës së shkruar.

Një spjegim diçka i ndryshëm mund të jepet për *i*-në e parë te fjala *indirë* nga lat. *unctura*. Po të nisemi nga trajta *undirë*, që ndihet në Vuno, kthimi i *u*-së në *i* mund të shihet si një asimilim regresiv. Sikurse u tha dhe më lart, kërkon spjegim *i*-ja në fjalë të tilla si: *il*, *di*, *si*, *i grinjë*, *ti*, *gjiq*, *indirë* etj., që reflekton një *ū* indoeuropiane ose latine.

Tingulli labial *ü*, në disa raste dhe *ö*<sup>13</sup>, i fjalëve të huajtura nga turqishtja janë reflektuar këtu me *u* dhe *i*; disa fjalë dalin në dy trajta: me *u* dhe *i*: a) *burazer* «*bürader*», *çurek* «*çörek*», *huqumet* «*hükümet*», *muezin* «*müezzin*», *mushteri* «*müşteri*», *musliman* «*müsliman*», *qurk* «*kürk*», *qumur* «*kömur*», *qufur* «*küfur*», *qurek* «*kürek*», *rushvet* «*rüşvet*», *turli* «*türli*», *surgjun* «*sürgün*», *xhube* «*cübbe*»; b) *diqan* «*dükân*», *dishek* «*düşek*», *disheme* «*düşeme*», *gjim* «*güüm*», *gjile* «*gülle*», *gjiveç* «*güveç*», *mifti* «*müfti*», *misafir* «*müsafir*», *qilaf* «*külâh*», *qip* «*küp*», *sinet* «*sünet*», *shiqir* «*şükür*; b) *burek* dhe *birek* «*börek*», *dufek* dhe *difek* «*düfek*», *umur* dhe *imër* «*ömr*», *gjunah* dhe *gjina* «*günah*».

Sikurse shihet nga shembujt e mësipërm, në të folmen e Gjirokastrës numri i fjalëve që e reflektojnë me *i ü*-në (*y*) e turqishtes, pothuajse është i njëjtë me ato që e reflektojnë me *u*. Në të folme të tjera të kësaj zone raporti ku më pak e ku më shumë ndryshon në të mirë të reflektimit me *u*, aq sa në disa pika si Delvinë, Borsh, Konispol etj. fjalë të tilla me *i* janë mjaft të paka. Me të folmen e Gjirokastrës qëndron më afër në këtë pikë e folmja e Vunoit ku gjithashtu ka mjaft fjalë, po gjithnjë më pak se të tjerat, në të cilat *ü*-ja është reflektuar me *u*.

Fakti që në këtë zonë të toskërishtes jugore në këto fjalë kemi përgjithësisht *u*; kurse në toskërishten veriore *y*, tregon që si *u*-ja e *i*-ja, si *y*-ja reflektojnë tingujt labialë të turqishtes së përbashkët *ü* (*y*) dhe *ö*. Në këtë mes e folmja e Kurveleshit të Sipërm, që e ka fonemën *y*, po që në disa nga këto fjalë ka *u*: *dufek*, *xhube*, *burazer*, *mufti*, *mustafir*, *mushteri*, *burek*, *çurek*, *surgjun*, krahas *dynia*, *dyshek*, *yrish*, *zymbyl*, *buzulyk*, *shyqyr*, *ymër*, nuk e ngatërron çështjen, sepse, duke qenë një zonë malore, ku pushtonjësit turq nuk sunduan dot drejtpërsëdrejti, po vetëm me anë të agallarëve vendës, nuk ka qenë kurrë nën ndikimin e drejtpërdrejtë të kulturës e gjuhës turke, kështu që pjesa më e madhe e fjalëve turke ka hyrë nëpërmjet të folmeve të tjera. Për ta bërë më të qartë përse u reflektua me *u* dhe *i y*-ja e turqishtes një rrethanë tjetër duket mjaft e rëndësishme: që reflektimi me *i* është më i përhapur në qendrat me popullsi ortodokse ose të përzier, ku gjuha turke nuk është futur edhe me anë të shkollës, e që përkundrazi reflektimi me *i* është shumë i kufizuar në ato vende si Borsh, Delvinë e Konispol me popullsi myslimane e që dikur kanë qenë qendra bejlerësh e për pasojë me një kulturë myslimane më të theksuar, ku gjuha turke mësohej dhe nëpër mejtepe. Mendimi im është ky: që *y*-ja është reflektuar me *i* në fjalët që janë marrë nga turqishtja e folur, dhe me *u* në fjalët e futura nëpërmjet shkollës. Siç është përmendur edhe më lart *y*-ja dhe sot reflektohet në këto anë me *i*, meqë *i*-ja është zanore e përparme e pra më afër *y*-së.

Dihet se një nga karakteristikat e alfabetit të vjetër turk është dhe kjo: që me shenjën *ü*/ shënoheshin këta katër tinguj: *ü* (*y*), *u*, *ö*, *o*. Pikë-

13) Tingulli *ö* në disa fjalë të tjera është reflektuar me *o*: qofte «*köfte*». Fjalët turke janë cituar sipas fjalorit *Lessico turco-italiano*, Romë, 1939 të Luigi Bonellit.

risht ky faktor thjesht grafik, besoj, ka bërë që bartësit e këtyre të folmeve pa *y*, që mësonin turqishten e shkruar, ta zëvendësonin *ü*-në e turqishtes me *u* si tingull më i afërt në krahasim me *o*-në dhe nuk e zëvendësuan me *i*, meqë *i*-ja shënohej me një tjetër shenjë. Mundet që në një etapë të caktuar reflektimi me *i* të ketë qenë më i përhapur (dmth. që shumë nga këto fjalë që sot kanë *u*, dilnin me *i*), sepse nuk mund të mendohet që të gjitha këto fjalë turke të kenë hyrë nëpërmjet shkollës, po më vonë ky reflektim me *i* është ngushtuar ose zëvendësuar pothuaj krejt nën ndikimin e turqishtes së mësuar në shkollë.

5.2. Zanores *y* në togun *ye* i përgjigjet këtu *i*-ja e cila në këto raste është e parë: *liej, ngjiej, krier, kapërcier, u kdhie, u thie, krie* etj. Vetëm në një rast i përgjigjet *j*, që është rezultat i zhvillimit fonetik të *i*-së pas çvendosjes së theksit nga *i*-ja mbi *e*-në: *pjës* < *piés* < *pies* «*pyes*», *pjeta, të pjet, pjetur* etj.

### Bashkëtingëlloret

6. Faringalja *h* ruhet mirë, si përgjithësisht në toskërishten jugore, në fillim e në mes të fjalës: *ha, heth, hump, herë, hejbe, hamulit* etj., *kohë, behar, muhabet, duhan, krahas, shohij, ftohët, ngrohët, pandehnë, kahvé, vjehra* etj.

6.1. Shpesh në fillim të fjalëve që nisin me zanore, shtohet një *h*: *harij* «*arrij*», *hunazë* «*unazë*», *hezmer* «*ezmer*» *Hamerikë* «*Amerikë*».

Një *h* epentetike del edhe në formën pësore të foljeve me temë më zanore, po kjo nuk është përgjithësuar, sepse hasen edhe raste, megjithse mjaft të rralla në krahasim me të tjerat, pa *h* epentetike: *ngrihem, thahesh, përtërihet, bëhej, nxiheshin* etj. *haej, ngriesh, shkrueshim* etj.

6.2. Në fund të fjalës *h*-ja në disa fjalë ruhet mirë, po në disa të tjera shqiptimi i saj është lëkundur. Mbahet më fort në fjalët e huajtura nga turqishtja, që kanë një përdorim më të kufizuar si: *silah, nigjah, katarah, gjunah* etj., ndërsa në fjalët me një përdorim të shpeshtë ajo herë ndihet e plotë, herë e reduktuar dhe herë nuk ndihet fare: *njoh, njeh, sheh*, zuri ta *rih, krah; sheh*, o të të *rah, njoh, fsheh*, do vete të *sho*, pa *shi* këta, *saba* etj. *meazadha* «*meazallah*» *gjina* «*gjunah*».

Në lidhje me këtë fakt edhe në trajtat e këtyre fjalëve, ku *h* do të ndodhej në mes të fjalës, ajo është lëkundur; kështu krahas rasteve ku *h* ndihet, raste që sigurisht janë më të shpeshta, ka dhe të tilla ku *h* nuk ndihet: *të shoç, nxetësi, ndihmoj, kriesha* etj.

6.3. Në nja dy fjalë *h*-ja ndihet diçka si tingull palatal, po jo aq sa *h*-ja që ndihet në Bregdet<sup>14</sup> e Muzinë<sup>15</sup>: *hje* «*hie, hjetonem* «*hietonem*», *i hjetuar* «*i hietuar*», *ahjere* «*atëhere*».

7. Ndrimi fonetik *q* : *j*, që vrehet në rastet kur palatalja *q* ndodhet para bashkëtingëlloreve *t, n, ç*, nuk është përgjithësuar. Ka raste që i njëjti person shqipton në këtë pozicion fonetik edhe *q*, edhe *j*. Në këtë mes trajtat me ndrim fonetik janë më të shpeshta: *plejtë, zojtë, fijtë, të lijtë, u pojnë, hojnë, hojçë* «*hoqa*» etj., *pleqtë, zoqtë, u poqnë, vdiqmë, poqmë*.

8. Për sa i përket zhvillimit të *nj*-së duhet thënë që ajo është ruajtur në rrënjë të fjalës, po nuk është ruajtur plotësisht në mbaresat e

14) Punim i cituar 186.

15) M. Totoni: *Vëzhgime për të folmen e Muzinës* në St. Filol. 1965, 3, 139.

shumësit e është ndruar në *j* në mbaresat foljore. Gjendja e sotme e këtij tingulli është e tillë:

Në sistemin emëror *nj*-ja fundore ruhet:

a) në shumësin e emrave mashkullorë: *ftonj, udhinj* «ullinj», *mudhinj* «mullinj», *qerinj* «qirinj», *kushurinj, thonj, poktonj, kazmenj* etj. Mund të përmendet këtu edhe shumësi i ndonjë mbiemri si të *mbëdhinj*. Në shumësin e emrave me *-inj* bashkëtingëllorja *nj* në disa raste ruhet në disa të tjera më të rralla është ndruar në *j*: *thelpinj, shkëmbinj* dhe *shkëmbij, shkopij, gjarpij*;

b) në emrat që tregojnë fisin ose llogarin, si: *Koçianj, Shapllanj, Shtinanj, Shehanj, Gozhitanj* etj.

Në sistemin foljor pavarësisht nga pozicioni fonetik *nj*-ja është ndruar në *j*: a) në vetën e I të së tashmes së dëftores e lidhores të foljeve të zgjedhimit të III, ku *nj*-ja është ndodhur në fund të fjalës: *bëj, dëftoj, gënjej, laj, lëshoj, të mbërthej* etj.; b) në vetën e I dhe të III shumës të së tashmes së dëftores, ku *nj*-ja është ndodhur para bashkëtingëlloreve *-m* e *-n*: *bëjmë, lajmë, fshijmë, grijnë, mbërthejnë, liejnë* etj., c) në vetën e I dhe të II njëjës të së pakryerës dhe në vetën e III njëjës të së tashmes së lidhores, ku *nj*-ja është ndodhur para zanoreve *ë, a* dhe *e*: *frijë, punojë, lajë, fshijë, dridhij, shkuli* (në këto dy fjalët e fundit *ë*-ja duke qenë fundore në një fjalë proparoksite, ka rënë) *dija, flitja, ngrije, kërkoje, mbruje, të hajë, të bëjë* etj.

Me vija të ngatërruara del pamja e këtij fenomeni, dmth. ruajtja e *nj*-së në mbaresë dhe kthimi i saj në *j*, edhe po ta shohin jashtë caqeve të kësaj së folmeje, pra si na paraqitet ky fenomen në të folmet që përfshin trualli gjuhësor në të majtë të Vjosës, brenda të cilit përfshihet dhe e folmja e Gjirokastrës. Këtu është karakteristikë e përgjithshme spirantizimi i *nj*-së në *j* në shumësin e së tashmes dhe të së pakryerës edhe në ato të folme, si në të folmen e Zagorisë<sup>16</sup>, ku shpesh herë në njëjës e këtyre kohëve *nj*-ja ruhet. Spirantizimi i *nj*-së në shumës vrehet edhe në të folmet e toskërishtes veriore, duke nisur që nga Përmeti, ku në njëjës ka vetëm *nj*. Përkundrazi në jug të këtij trualli, në Konispol, në mbaresat e njëjësit dhe të shumësit të së pakryerës *nj*-ja përgjithësisht ruhet, ndërsa është ndruar në *j* kudo në mbaresat e së tashmes. Po ky pështjellim është edhe në sistemin emëror. Në Zagori psh. *nj*-ja fundore në emrat patronimikë sot ndihet *j*, po në gjindore-dhanore ruhet: *Mukaj-Mukanje, Kllapaj-Kllapanje* etj. Në Kurvelesh e Bregdet ajo gjithkund në sistemin foljor ndihet *j*. Në shumësin e emrave herë ndihet *nj* e herë *j*, përdorim që nuk përcaktohet nga ndonjë faktor. Në këtë mes tri gjëra dalin të qarta: që këtu *nj*-ja ka marrë rrugën për *j*, po procesi është në zhvillim e sipër, që ky proces ka filluar në sistemin foljor, e më saktësisht në mbaresat e shumësit të së tashmes dhe së pakryerës, që, më në fund, analogjia këtu ka lojtur dhe lot një rol të madh.

Mendimi im është që ndrimi *nj*:*j* është rezultat i një disimilimi. Pas rënies së zanores lidhëse *ë* në shumësin e së tashmes u formuan grupet bashkëtingëllore prej dy okluzivesh *njm* e *njn* të zorshme për t'u shqiptuar (në gjuhën shqipe nuk gjenden të tilla grupe bashkëtingëlloresh), prandaj njera prej këtyre bashkëtingëlloreve, *nj*-ja, u shndrua në koresponduesen e saj frikative *j*. Kështu paraqitet ky fenomen në vijat e tij më të përgjithshme, po, duke e parë këtë në të folme të veçanta, lindin mjaft pyetje që duan sqarime të tjera si p.sh.: pse në Kurvelesh

16) Punim i cituar 187.

kemi *j* në një trajtë të tillë si *punojëm?*, ose pse në Konispol kemi në të tashmen: v. I *laj*, shumë v. I *lajm*, v. III *lajn* etj., në të pakryerën: v. I *mbëlonj* «mbuloja», dhe *vej* «vija», v. II *mbëlonje* dhe *doje*, shumë v. I *mbëlonjëm*, v. II *mbëlonjët*, v. III *mbëlonjën* etj.? Këtu nuk është vendi të sqarohet çdo gjë, po, po të kihet parasysh ndikimi i të folmeve mbi njera tjetrën si edhe se veprimi rrafshonjës i analogjisë s'ka qenë i njëjtë në çdo të folme, disa gjëra bëhen të qarta. Një rrugë e tillë ndofta duhet menduar dhe për gegërishten, po aty çështja është më e ndërlikuar, meqë *nj*-ja ndrohet në *j* dhe në rrënjë të fjalës, e mund të jetë rezultat i mpleksjes së disa faktorëve.

9 — Një nga tiparet që e dallon këtë të folme nga shumë të folme të tjera të kësaj ane, është ruajtja e bashkëtingëllores *z* para një bashkëtingëlloreje të zëshme: *zborë*, *zboj*, *zbruhet*, *zburdhuhet*, *zbuloj*, *zbraz*, *zbath*, *zgjebe*, *zgjedhë*, *zgjoj* etj. Në pak raste para një bashkëtingëlloreje të zëshme, sidomos para një *v*-je ndodh të ndrohet *z*-ja në *x*: *xvol* «zvol», *xverk*, *Boxgo* «Bozgo». Ndrimi i *z*-së në *x* vrehet edhe në ndonjë rast ku ajo ndodhet para një zanoreje: *gabxer* «gabzer», *xamare* «zamare».

10. Edhe në ruajtjen e *sh*-së në fillim të fjalës e para bashkëtingëlloreve të shurdhëra kjo e folme dallohet nga të folmet e tjera në veri dhe lindje të saj, të cilat në një numër të caktuar fjalësh e ndrojnë *sh*-në në *ç*. Ja disa shembuj: *shkul*, *shkel*, *shkrij*, *shkoq*, *u shkriferua*, *shpoj*, *shportë*, *shquaj* etj.

10.1. Po, nëqoftëse në fillim të fjalës *sh*-ja është ruajtur, në mbaresat foljore ajo është ndruar në *ç* si në mes të fjalës dhe në fund të saj. Edhe në këtë pikë e folmja e Gjirokastrës dallohet nga të folmet që u përmenden më lart, të cilat *sh*-në e ndrojnë në *ç* vetëm në vetën e II njëjës të së tashmes së lidhore, po e ruajn në të kryerën e thjeshtë edhe në dëshërore: *të japç*, *të ritiç*, *të bëç*, *të bleç*, *të kuptoç*; *thaçë*, *paçë*, *dhaçë*, *laçë*; *gjefça*, *u trashëgoç*, *roççi*, *shkofçim* etj. Rastet ku ruhet *sh*-ja, janë shumë të rralla: *të duash*, *pafsha*, *hëngësh* e ndonjë tjetër.

11. Në sistemin fonetik të kësaj së folmeje nuk bën pjesë edhe dri-dhësja *rr*. Në vend të saj ka kudo *r*: *rip* «rryp», *rush*, *roj*, *ferë*, *harova*, *ndroj*, *proj* «përroi», *mar*, *nxjer* etj. Ky tipar gjithashtu e dallon këtë të folme nga të folmet që ndodhen në veri e në perëndim të saj.

12. Një *l* palatale e vjetër e shqipes (lj) nuk është zhvilluar në *j* sikundër ka ndodhur përgjithësisht në shqipen: *bilë*, *fëlej*, *fëmilë*, *fal*, *golë*, *milë*, *ndëlej* «ndej», *palë*, *palcoj*, *shilë*, *val*, *vrasëlë* «vrasje», *shëshëlë*, *lidhëlë*, *Hadëlë*, *Hamzëlë* «gruaja e Hamzait» etj. Nga pikëpamja fonetike kjo *l* është e njëjtë me atë të mbarë shqipes, kështu që nuk ka asnjë ndryshim fonetik midis *l*-së në *palë* «pajë» dhe *kalë*, ose *val* «vaj» dhe *dal*.

13. Tipari më karakteristik i së folmes së Gjirokastrës në konsonantizëm është ndrimi i *ll*-së në *dh*. Ky fenomen që në jug është mjaft i kufizuar (haset edhe në Libohovë dhe Delvinë), e dallon shumë këtë të folme nga të folmet e tjera përreth. Me përjashtim të disa rasteve fenomeni në fjalë është përgjithësuar kudo, aq sa në një vështrim të përgjithshëm të duket se këtu nuk ndihet fonema *ll*: *dhamarinë* «llamarinë», *dhambë*, *dhapë* «llapë», *dhastikë*, *dhafosëm*, *dhajë* «llajë», *dhotur* «lhotur < rotull», *dhaport* «llaport < raport»; *avudhi*, *adhonar*, *ambredhë*, *budadha*, *bakdhava*, *dodhap*, *didhë* «dyllë», *dadhandushe* «dallandyshe», *medhi*, *fdhackë*, *fidhoj*, *grumbudhore* «grumbullore», *i gjadhë*, *hadhe*, *udhoj kasodhe*, *këdhëf*, *kadhi*, *kadhamboq*, *kudhoj*, *medhan*, *mbidhur*, *meazadha* «meazallah», *mëdhënjë*, *madhëkoj*, *mjergudha*, *mudhë*, *okdhar*.

*pedhg* «pellg», *puhumb* «pëllumb», *sqetudhë*, *shtudhungë* «shtëllungë», *shkadhë*, *shëdhirë*, *thëdhim*, *udhi* «ulli», *vëdha*, *çakadh*, *dedh*, *fidh*, *miedh*, *pridh* etj.

13.1. Aty këtu krahas trajtave me *dh* ndihen edhe trajta me *ll* : *bakllava*, *budalluçkë*, *bullë*, *ballgam*, *dallandushe*, *këshlla*, *kulloj*, *okllai*, *pllakos*, *qollopitë*, *sqetull*, *uthull*. Raporti i shëmbujve me *dh* e *ll*, që janë regjistruar, është i tillë: 193 shëmbuj ku *ll*-ja është ndruar në *dh* dhe 25 ku *ll*-ja ruhet. Nga këta 25 shëmbuj 7 i ka thënë subjekti Nr. 4 dhe 8 subjekti Nr. 14. Te këto dy subjekte raporti i shëmbujve me *dh* e *ll* është: tek i pari 40 me 7, tek i dyti 20 me 8, ndërsa te subjekti Nr. 8 — 15 : 1. Kjo statistikë, megjithse deri diku subjektive, jep një ide të përgjithshme për gjendjen e sotme të fonemës *ll*: ndihet deri diku në të folmen e brezit të ri e të mesëm, sidomos të burrave, po është mjaft e rrallë ose s'ndihet fare në të folmen e brezit të vjetër e sidomos të grave. Sa për shëmbujt me *ll*, këta në një pjesë duket se janë riformime në bazë të gjuhës së shkruar, po në ndonjë rast, sidomos në fjalë me prejardhje nga turqishtja, mund të kemi të bëjmë me tingull të ruajtur.

13.2. Në disa fjalë të vjetra të shqipes dhe në disa të tjera të huajtura nga greqishtja, sllavishtja e turqishtja, të cilat në shumë të folme dhe në gjuhën e shkruar dalin me *ll*, këtu ka *l* : *il* «yll», të *tila*, *lucë*, *hali*, *protokale*, *avli*, *daule*.

14 — Bashkëtingëllorja *dh* në të folmen e brezit të vjetër ruhet kudo pa lëkundje: *dhadhë* «dhallë», *dhogë*, *dhiqel*, *dhez* «ndez», *dhi*, *dhëndëri*, më *dhëmp* *dhëmbi*; e *bardhë*, *erdha*, *udhë*, i *madhi*, *hodha*, *lodhem*, *kabadhë*, i *verdhë*, *zgjedhë* etj.

14.1. Në brezin e mesëm dhe të riun, të shkolluar e të dalë, ndodh ndrimi *dh* : *ll* : *llogë* ja *lla* «dha», më *llëmp* *llëmbi*, *llëmbjet*, të *mbëllatë*, *u gllifç*, *erlla*, *apllalle* «aplladhe», *kaballë*, *kaballul*. Më shpesh dhe tek më shumë subjekte ndrimi i *dh*-së në *ll* është vrejtur në fjalën *llogë*.

Ky fenomen nuk ndihet thujtë fare në brezin e vjetër, prandaj mund të flitet për një moshë të re të tij. Nga materialet del se ndrimi *dh* : *ll* është më i shpeshtë tek ata persona që shqiptojnë më shumë *ll*-në, si p.sh. te subjekti Nr. 14, te një i ri etj., gjë që të shtyn të mendosh se ky fenomen është rezultat i një përdorimi të pavend të *ll*-së që mungon në këtë të folme, nën ndikimin e të folmeve të tjera dhe sidomos të shkollës e të gjuhës së shkruar. Një fenomen i ngjajshëm ndodh edhe në Përmet e Korçë në lidhje me shqiptimin e *h*-së. Shpesh persona të brezit të mesëm dhe të ri, duke dashur t'i afrohen në shqiptim gjuhës letrare, përdorin pa vend *h*-në, sidomos në fillim të fjalës. Këto fenomene që në fillim s'kanë karakter dialektor, me kohë përgjithësohen dhe fitojnë të drejtën të jetojnë si të tilla, po, për sa i përket fenomenit të ndrimin të *dh*-së në *ll* në Gjirokastër, ende nuk mund të thuhet një gjë e tillë.

15. Grupet bashkëtingëllore *mb*, *nd*, *ng* në fillim dhe në mes të fjalës nuk pësojnë ndonjë ndryshim: *mba*, *këmbë*, *dhëmb*, *ndroj*, *kandil*, *mënd*, *ngas*, *shtrungë*, *lëng* etj.

15.1. Në grupin *ngj* bashkëtingëllorja *n* si rezultat i ndikimit të qielëzores *gj* paraqitet në shumicën e rasteve e palatalizuar në *nj*: *njgjallë*, *njgjadhëm*, *njgjesh*, *njgjiej*, e *njgjacur*, *mënjgjes*, *qenjgji*, *fiq* të *shënjgjinës*, *thinjgjidh*, *zenjgji*, *ënjgjedh*, *sinjgjenia* etj. Në disa raste pa dallim lagjeje, bile tek i njëjti person, ndihet në trajtën *ngj* pa *n* të palatalizuar: *u ngjadh*, është *ngjadhur*, *kongjidh*, *krongjidh*, *shëngjinës*, *mëngjës*. Ky fenomen në të folmet e tjera të Labërisë paraqitet i përgjithësuar në të

tëra rastet, me përjashtim të krahinës së Lopsit të Tepelenës, ku vrehen raste të ruajtjes së grupit *ngj* si në Gjirokastrë.

15.2. Grupet *kl* e *gl* janë ndruar në *q* e *gj*: *qënë*, *qumësht*, *qishë*, *gju*, *gjëmbi*, *gjisht*, *zgjith* etj.

15.3. Grupet *lk* e *lg* janë ruajtur: *alkë*, *bulk*, *ulk*, *balgë*. Bashkëtingëlloerja *l* e këtij grupi ruhet dhe në ato raste ku *k*-ja palatalizohet në *q*: *oulqit*, *bulqësi*, *ulqër*.

16. Bashkëtingëlloret e zëshme, duke futur këtu dhe *dh*-në që vjen nga *ll*-ja, në fund dhe në mes të fjalës para një bashkëtingëllorije të shurdhët ndihen si bashkëtingëllore joplotësisht të shurdhuara. Ato karakterizohen nga një tension muskular më i madh dhe një rrymë ajri më e fuqishme se bashkëtingëlloret e zëshme. Midis këtyre bashkëtingëlloreve joplotësisht të shurdhuara vrehet një ndryshim i vogël: okluzivet *ð*, *d*, *g*, *gj*, *xh* duket se janë më afër të shurdhëtavet në krahasim me shtegoret *dh* e *z*. Këtu këto lloj bashkëtingëlloresh po i shënojmë si të zëshmet për të vënë në dukje këtë tipar të tyre, i cili në krahasim me shumicën e të folmeve toske del si specifik: *sheleg*, *qengj*, *gërmaz*, *borxh*, *i madh*, *vidh*, *hedh*, *u nËgjadh* «u ngjall», *i dhogtë*, *njerzt*, *u lodhç*, *padhto* etj.

17. Në disa fjalë si *digan*, «tigan», *budër* «pudër», *belte* «pelte» *xhurape* «çorape» vrehet sonorizmi i pakondicionuar i bashkëtingëlloreve në fillim të fjalës. Po me interes paraqet këtu sonorizmi i *s*-së në fjalë të tilla si: *lizi* «lisi», *liza*, *puzi*, «pusi», *puze*, *qelbëzi* «qelbësi», *qerozi* «qerosi» etj. Në këto raste kemi të bëjmë me sonorizime analogjike në bazë të modeleve të tilla: *mëz-mëzi*, *Elmaz-Elmazi*, ku *z*-ja është origjinare dhe në fund të fjalës paraqitet si bashkëtingëllore joplotësisht e zëshme.

18. Fenomeni i asimilimit nuk vepron më në këtë të folme. Raste të tilla si: *muarnë*, *thernë*, *varnë*, *folni*, *dilni*, *villni*, *mbytnë*, *pritrnë*, *ngritrnë*, *flitrni* etj., ku grupet *rn*, *ln*, *lln*, *tn* nuk asimilohen, përbëjnë rregull. Në gjendjen e sotme të kësaj së folme grupe të tilla bashkëtingëllore formohen në vetën e II shumës të së tashmes e të urdhërores si dhe në vetën e III shumës të së kryerës së thjeshtë. Në kallzore nuk formohen, meqë mbaresa *-në* e saj është zëvendësuar me të renë *-in*.

Me gjithë atë si mbeturina të një faze, kur ky fenomen ka qenë i gjallë në këtë të folme, hasen fjalë ku këto grupe paraqiten të asimiluara. Kjo gjë ndodh në rasën kallzore: *zjarë* «zjarnë», *hatërë* «hatërnë», dhe në vetën e III shumës të së kryerës së thjeshtë: *muar* «muarnë», *fualë* «fualnë», *mbidhë* «mbillnë, mbyllnë», *miedhë* «miellnë», *panë* «patnë», *këpunë* «këputnë», *mbenë* «mbetnë».

Qoftë në rasën kallzore, qoftë në të kryerën e thjeshtë, zanorja *-ë* që ka mbetur nga mbaresa *-në* pas asimilimit të bashkëtingëllores *n*, është kuptuar si mbaresë dhe është shtrirë për analogji dhe në disa raste ku asimilimi do të ishte i pamundur, meqë një bashkëtingëllore josonante nuk mund të asimilohet një sonate: *xhepë* «xhepin», *mitrolozë* «mitrolozin», *erdhë* «erdhën», *u mbluadhë* «u mbluadhën», po këto janë mjaft të rralla.

## MORFOLOGJIA

## Emri

19. Gjinia asnjaneë është ende e gjallë dhe bile jo e rrallë. Ruhët mirë në emrat që tregojnë lendë, në një kategori emrash foljorë dhe në emrat që vinë nga mbiemrat: u haej *misht* /, zien *mishtë* /, shosha *grurët* /, njgjesh *brumët* /, o ta sitis *miedhtë* /, *dhjamët* e dashit /, mblodhi *gjalpët* /, ka ngrirë *ujët* /, e heq vër e vër *leshtë* /, pas së *lindurit* /, ju pre të *ngrënët* /, vdis njeriu së *pathënit* /, të *ngrohët* etj. Del në gjininë asnjaneë edhe emri *badhtë* «balli»: m u vranë *badhtë* /, i cili, kur përdoret si kryefjalë e një fjalie, kërkon që folja-kallzues e saj të jetë në numrin shumës. Ky fenomen ngjet edhe në vende të tjera si Zagori: më dhëmbin *ballët* /, Picar (Kurvelesh): më dhëmën *ballët* /. Po sidomos karakteristik është përdorimi në asnjaneë i emrit «emër»: si e ke *ëmërit?*, sh ta thon *ëmërit?*, mos ja dëgjofa *ëmërit!*, e vure dhe emëritë?.

Si kudo dhe këtu asnjaneësi ka filluar të zëvendësohet me gjininë mashkullore: *qumushti*, *mishin* etj., po me gjith këtë në ndonjë rast mbiemri që cilëson një emër të tillë, ruan gjininë asnjaneë: *qumështi* këtu është *t ëmblë* /.

20. Disa emra të tipit *bri-ri* (geg. *brî-ni*), kur shquhen, në emëroren njëjës, për analogji me emra të tipit *mi-u* nuk e nxjerrin bashkëtingëlloren *-r* të rrënjës dhe marrin nyjën *u*: *kushuri-u* «kushërirë», *kadhi-u* «kalliri», *flori-u* «floriri».

20.1. Emrat e gjinisë femërore më *-e* dhe *-i* të theksuar nuk marrin *j* para nyjës *a*: *çiltë-a* «shilteja», *dishemé-a* «dysHEMEJA», *pirosti-a*, *shtëpi-a*, *lajthi-a* etj.

20.2. Emrat femërorë më *-a* dhe *-o* marrin para nyjës shquese bashkëtingëlloren *j*: *futa-ja*, *masha-ja*, *huja-ja*, *gliko-ja*, *kondo-ja* etj.

20.3. Emrat femërorë më *-e* të patheksuar e humbasin *e*-në kur shquhen, kurse para nyjës *-a* marrin *j* dhe *i* në shumicën e rasteve: *deledja*, *vadhe-vadhja* «vallja», *nuse-nusja*, *kuçumare-kuçumarja* etj. *kaliqekaliqia*, *koqe-koqia*, *faqe-faqia*, *shoqe-shoqia*, *cakure-cakuria*, *manaremanaria*, *cule-culia*, *cërmëdele-cërmëdelia*, *mëze-mëzia*, *kurube-kurubia* «korube», *ethe-ethia*, *patërxhane-patërxhania*, e *ënjte-e ënjtia*, *nuse-nusia*, *mësuese-mësusia* etj. Edhe ky fenomen nuk është i kufizuar vetëm këtu. Haset edhe në krahina të tjera të Labërisë si në Lunxheri, Bregdet i Poshtëm, Kurvelesh etj. ku më shumë e ku më pak i përgjithësuar. Sidoqoftë është vërtet më tepër në ato fjalë që mbarojnë me *-qe* e *-gje*, si faqe etj. Besoj që në rastet e tjera kemi një përhapje analogjike, që ka zënë fill nga ky tip. Një bashkëtingëllore palatale ose dhe një likuide para kësaj *j-je* ka ndikuar në kthimin e saj në *i*, po ndoshta një rol me rëndësi ka lojtur dhe lot këtu trajta e shquar e emrave të tipit *shtëpia*.

21. *Shumësi i emrave mashkullorë*. Ky shumësi përbën një nga aspektet karakteristike të morfologjisë së kësaj së folmeje, që e dallon nga të folmet përreth. Këtu ka fituar një gjallëri mjaft të madhe mbaresa *-e*, kurse është kufizuar në përdorim mbaresa *-ë*. Prirja kryesore këtu është përhapja gjithnjë e më e madhe, përgjithësimi i mbaresës *-e*, qoftë dhe si mjet sekundar, në shumësin e emrave mashkullorë që tregojnë jofrymorë.

21.1. Mbaresa *-ë*. Në krahasim me të folmen e Kurveleshit, Lunxherisë, Rrëzës së Tepelenës, Zagorisë etj. kjo mbaresë ka një përdorim të kufizuar, përdoret kryesisht për të formuar shumësin e emrave që tre-

gojnë frymorë: *baxhanak-ë, badhist-ë, hajdut-ë, tradhtar-ë, kusar-ë, hismeqar-ë, oficer-ë, musliman-ë, dembel-ë, sheleg-ë, shterpor-ë, milor-ë, gomar-ë, langor-ë, zagar-ë, kulish-ë, çakadh-ë, urith-ë, kokosh-ë, bilbil-ë, gushkuq-ë, larash-ë, ksifter-ë* «skifter» etj.

Emrat që tregojnë jofrymorë dhe që e bëjnë shumësin me -ë, janë të pakë: *damar-ë, kapak-ë, kulaç-ë, çekiç-ë, sandraç-ë, jongar-ë, masur-ë, tevlík-ë, zagorec-ë, spithar-ë*. Shumica e këtyre emrave janë të kufizuar në përdorim, se u përkasin sferave të veçanta si: zejeve e bujqësisë. Në krahinat që u përmenden më lart, në këto raste mbaresa -ë ka një përdorim shumë më të madh.

21.2. Shumësi me mbaresën -a<sup>17</sup> është i kufizuar. E marrin këtë mbaresë si emra që tregojnë frymorë, dhe emra që tregojnë jofrymorë: *der-a* «derra», *hamurik-a, dem-a, pullumb-a, krimb-a, liz-a, muriz-a* «murriz», *cep-a, qingël-a*, si dhe *frër-a* «frë», *gjir-a*, «gji».

21.3. Mbaresa -e është më produktivja, ajo po përgjithësohet në shumësin e emrave që tregojnë jofrymorë, si duke zëvendësuar mbaresat e tjera edhe duke u përdorur si mbaresë e dytë psh. xverk: *xverqe*, vark: *vergje*, krua: *kronjre* etj.<sup>18</sup>

E formojnë shumësin me këtë mbaresë:

Emrat abstraktë me prapashtesën -im dhe të tjerë: *ndërtim-e, punim-e, sihariq-e, vaft-e, hadh-e*, «hall», *adet-e, zakon-e* etj.

Emra që tregojnë bimë, mjete dhe vegla të ndryshme, pjesë të trupit etj.: *man-e, frashër-e, çerçem-e, radhiq-e, haur-e, katoq-e, kotec-e; mur-e, tavan-e, divan-e, pat-e, spreth-e, bragaç-e, bod-e, bez-e, cimbidh-e, çengel-e, çarçaf-e, dodhap-e* «dollap», *djep-e, destemel-e, dajan-e, fron-e, filxhan-e, gaz-e, gjim-e, gjalm-e, gjiveç-e, jorgan-e, kazan-e, kucur-e, kason-e, katarah-e, kalem-e, kadhkan-e* «kalkkan», *minder-e, makat-e, mezar-e, puz-e, peshqesh-e, post-e, pirun-e, padhdëm-e* «palldëm», *qip-e, qurek-e, sqepar-e, sahan-e, sergjen-e, shul-e, digan-e, xhamadan-e, xhep-e* (dhe *xhep-a*), *bel-e, dhiqel-e, kalistir-e, kosor-e, sirt-e, xvol-e, bilur-e, gërmaz-e, gjoks-e* etj.

21.3.1. Me këtë mbaresë e bëjnë shumësin edhe disa kategori emrash të cilët në të folmet përreth dhe në toskërishten e shkruar marrin mbaresë të tjera. Këtu mund të përmenden:

17) Këta emra kanë prirje ta ndrojnë gjininë në shumës. Kjo është e rregullt kur kemi të bëjmë me emra që tregojnë jofrymorë si *gjëmba* të shumta /, *vreshtat* janë të paka /, po s'është përgjithësuar në emrat që tregojnë frymorë: *puhdumba* të bukura, /, këto *krimba* /, po *dera* të mbëdhinj /. Ndrimi i gjinisë është përgjithësuar në shumësin me -ra: *mishra* të pjekura /, me *peshqeshera* të mira / etj.

18) Të gjithë shumësat me -e, qoftë e-ja dhe mbaresë e dytë, e ndrojnë gjininë në shumës; këtu nuk ka rëndësi në tregon ky emër diçka abstrakte apo diçka konkrete, mjaft që ky të tregojë një jofrymor: në *vaft* të para /, n ato *vaft* /, ç janë këto *betere?*, pas *zakonevet* së para /, *sqepare* shumë të mira /, *puse* të thedha /, di *kotece* të mira /, *gjokse* të gjera /, kem tre *jorgane* të bukura /, *samare* të pri-shura. /, *gjime* të bakërta /, kam di *drapre* të ra /, blemë këto *makatet* /, ka *caqe* të vogëla /, *dufeqe* të gjata /, *ibriqe* të mbëdha /, këto *barqe* /, shidha gjithë këto *pedhqe* me ujë!, i ke *gjishtret* të hodha /, *kronjre* të bukura /, *boshtr* të drunjta /, *koshtere* të mbëdha /. Në nja dy raste edhe emra që tregojnë frymorë, e ndrojnë gjininë në shumës: *lepure* të bukura /, *zorkadhe* të bukura /, po shumica e tyre e ruajnë: këta *cinxret*, *kecre* të mëdhenj, këta *viçre*, *qenjjre* të mbëdhenj / etj. Në këtë pikë kjo e folme afrohet me atë të Delvinës dhe Libohovës dhe dallohet nga të folmet e tjera labe dhe nga e folmja e Konispolit, në të cilat ndrimi i gjinisë në shumësin e emrave me -e ndodh vetëm në emrat abstraktë si *punime*, *ndrime*, *vaft* etj., ndërsa me përjashtim të emrave *vënde* e *male* nuk ndodh në emrat që tregojnë sende konkrete. Një gjë del e qartë këtu: që përhapja e këtij fenomeni ka të bëjë me gjallërinë e mbaresës -e.

emrat me prapashtesën -ës: *qelbëz-e* «qelbës», *haps-e*;

emrat që mbarojnë me një -dh që vjen nga ll-ja: *konjgjdh-e* «konjgill», *kërmidh-e*, *kungudh-e*, *ënjgjëdh-e*, *fidh-e* (edhe *fidh*: «u jep tre *fidh* pishe»). Shumësi i emrit il «yll» është *il-e* dhe *il*: «ilt e qiedhit».

Hyjnë këtu dhe disa shumësa si: *gardh-e*, *bash-t-e* (dhe *bosht-re*) *thelp-e*, *drapr-e*, *lëmsh-e*.

21.3.2. Emrat mashkullorë që tregojnë frymorë dhe që e bëjnë shumësin me -e, janë mjaft të pakë: *zorkadh-e*, *lepur-e*, *bexhek-e*, *cinxër-e* (edhe *cinxër*) dhe *ënjgjëdh-e* që u përmend më lart.

21.4. Emrat që mbarojnë me -k e -g, e bëjnë përgjithësisht shumësin duke palatalizuar -k-në e -g-në në -q e -gj: *bulk-bulq*, *turk-turq*, *plak-pleq*, *krushk-krushq*, *pishk-pishq*, *fik-fiq*, *zog-zoq*.

Shumica e këtyre emrave marrin edhe mbaresë të dytë: ata që tregojnë frymorë, mbaresën -ër, ata që tregojnë jofrymorë, mbaresën -e: *ulk-ulqër*, *fcurk* «*cfurk*, *akrep*»-*fcurqër* (Dunavat i I, *cfurqe* — Varosh, Lagjia Teqe), *shtrig-shtrigjër*; *dufek-dufeqe*, *çakmak-çakmaqe*, *jastik-jastiqe*, *ibrik-ibriqe*, *jelek-jeleqe*, *birek-bireqe*, *zverk-xverqe*, *dibek-dibeqe*, *kapak-kapaqe* (edhe *kapakë*), *bark-barqe*, *dishek-disheqe*, *sunduk-sunduqe*, *mustuk-mustuqe*, *oxhak-oxhaqe*, *prak-praqe*, *sofadhëk* «*sofatllëk*»-*sofadhëqe*, *juk-juqe*, *pashmak-pashmaqe*, *nevrik* «*z dijnë kurë nevriqe*», *hendek-hendeqe*, *cak-caqe*, *shifek* «*fyshek*»-*shifeqe*, *çirek-çireqe*, *shajak-shajaqe*, *shark-sharqe* (dhe *sherqe*), *pedhg* «*pellg*»-*pedhgje*, *varg-vergje*.

21.5. Janë të pakë emrat që e bëjnë shumësin duke metaforizuar zanoren e rrënjës. Shumica e tyre marrin edhe mbaresë të dytë: -ër, ata që tregojnë frymorë, dhe -e, ata që tregojnë jofrymorë: *dash-desh*, *cjap-cjep*, *kunat-kunet* dhe *kunetër*, *vëdham* «*vëllam*» — *vëdhemër*, *shtrat-shtrete* (Manalat i II, *shtrate* — Lagjia Teqe), *prak-preqe* (Manalati II, *praqe* — Manalati i I), *trap-trepe*, *stan-stene* (Manalati i II, *stane* — Dunavat), *kulaç-kuleçe* (Manalati i II, *kulaçe* — Varosh). Në krahasim me të folmen e Kurveleshit e të Konispolit ky lloj shumësi paraqitet më i kufizuar.

21.5.1. Në disa emra të tjerë krahas metafonisë në shumës ndodh dhe palatalizimi i bashkëtingëllores së rrënjës *çoban-çobenj*, *koçan-koçenj*, *kurban-kurbenj*, *mashkudh* «*mashkull*»-*meshqudh*, *ka-qe*.

21.6. Me mbaresën -nj e bëjnë shumësin emrat që në shqipen e lashtë kanë mbaruar me -n: *ftua-ftonj*, *thua-thonj*, *fitua-fitonj*, *frastua-frastonj*, *poktua-poktonj*, *mudhi* «*mulli*»-*mudhinj*, *kërci-kërcinj*, *qeri-qerinj* (dhe *qerij*), *udhi-udhinj*, *kushëri-kushurinj*, *kadhi* «*kalli*»-*kadhinj*, *flori-florinj*.

Disa të tjerë marrin -re si mbaresë të dytë: *krua-kronjre*, *prua-pronjre*, *dru-drunjre*.

21.6.1. Marrin -nj edhe disa emra që mbarojnë me -a. Krahas -nj-së metafonizohet dhe a-ja: *fukara-fukarénj*, *kazma-kazménj*, po kështu *tra-trenj*.

21.7. Me mbaresën -inj (-ij) e bëjnë shumësin një kategori e kufizuar emrash si: *thelp-inj* (edhe *thelpe*), *shkëmb-inj* (dhe *shkëmb-ij*), *shkop-ij*, *gjarp-ij*.

Emri *mës* e bën shumësin me mbaresën -énj: *mézénj*.

21.8. Mbarea -ër ka një përdorim të kufizuar këtu në krahasim me krahinat përreth. Ky ndryshim nuk ka karakter krahinor, po qytet-fshat. Përgjithësisht në qytete haset rrallë, në fshatra më dendur, sidomos në terminologjinë e sferës së blegtorisë dhe bujqësisë. Me këtë mbaresë e formojnë shumësin emra që tregojnë frymorë: *lab-ër*, *zabit-ër*, *nip-ër*, *zudhap-ër* (edhe *zudhepër* «*zullap*») *kroç-ër*, *gjon-ër*, *buf-ër*, *përç-ër*,

*qenjgj-ër* (dhe *qenjgjre*), *shut-ër*, *krut-ër*, *vrizul-ër*, *mazhul-ër*, *kuac-ër*, *kucokrut-ër*.

Në disa raste kësaj mbarese i ngjitet dhe një mbarese tjetër *-a* ose *-e*: *bisht-ra*, *kosht-ëra*, *bosht-re*, *gjisht-re*, *kec-ëre*, *viç-re*.

21.9. Emrat që mbarojnë më *-i* të theksuar, të tipit *mi-u*, *furxhi-u* etj., kanë të njëjtën formë si në njëjës dhe në shumës: *mi-mi(të)*, *bekshi-bekshi(të)*, *axhami-axhami(të)*, *furxhi-furxhi(të)*, *piri-piri(të)*.

Në analogji me këta e bëjnë shumësin edhe disa emra që kanë pasë mbaruar me nazale si: si «*sy*» *-si(të)*, *bli-bli(të)*, *kadhi-kadhi(të)*, (*krahas-kadhinj*), *bri-bri(të)*, *turi-turi(të)*.

21.10. Për t'u përmendur janë dhe shumësit e këtyre fjalëve: *vësht-vreshta*; *djalë-djelm* dhe *djem*, shumës me metaforë dhe me zgjerim të temës me *-m*. Trajta *djelm* haset dhe në anë të tjera të Labërisë e në ndonjë nga ato (Bregdet i Poshtëm psh.) trajta e shquar del pa zgjerimin me *-m*, pra *djelt*. Shumësi i «*kalë*» është *kuel*, shumës me plot variante në këto krahina: *kual* (Kurvelesh, Bregdet i Poshtëm), *kelt* e *qiqes* (Bregdet i Poshtëm), *kuaj* (Zagori).

22. Në këtë të folme ka një përdorim mjaft të gjerë shumësi me *-ra*, i quajtur shumësi i llojit. Ndeshet si në emrat mashkullorë dhe në femërorët, me ndryshimin që në mashkullorët është i kufizuar në emra që tregojnë lëndë, si: *mish-ra* etj., dhe në ata që e bëjnë shumësin me *-e*, si: *ile-ra*, *peshqeshe-ra*, *qebape-ra*, *ushqime-ra* etj., ndërsa në emrat femërorë është mjaft i rëndomtë: *meze-ra*, *erë-ra*, *punë-ra*, *gjedhë-ra* «*gjellë*», *brucë-ra*, *torvë-ra*, *pjato-ra*, *shtëpi-ra*, *dasmë-ra*, *plehë-ra*, *kuti-ra*, *vogëlinë-ra*, *bajame-ra*, *kanedhë-ra* «*kanellë*», *këngë-ra*, *magje-ra*, *kusi-ra*, *fundë-ra*, *gjëmë-ra*, *frikë-ra* etj. Si në mbarë shqipen dhe këtu shumësi me *-ra* tregon llojin psh. «(ja shtrojmë) me raki / me mezero //», po në shumë raste nuk ka idenë e llojit. Në shëmbullin: «(e bëjnë) me bajamera të celfosura //» trajta *bajamera* jep thjesht idenë e shumësit, ndërsa *kanedhëra* në shëmbullin «(i hedhim) dhoi dhoi erëra / *kanedhëra* //» duket që është një formim analogjik, sepse nuk tregon as shumësin si shumës, as shumësin e llojit. Të këtij tipi besoj janë dhe shumësit *ilera*, *qebapera*, *peshqeshera* të emrave mashkullorë *il*, *qebap*, *peshqesh*.

23. *Kallzorja*. Emrat mashkullorë që mbarojnë me zanore të theksuar, e formojnë trajtën e shquar të kallzores duke marrë drejtpërdrejt mbare-sën *-n(ë)*: *kushuri-në*, *pë-në*, *njeri-në*, *thua-n* etj. Kjo mbarese del fort rrallë dhe në disa emra mashkullorë me temë më bashkëtingëllore ose më *-ë* të patheksuar: *çiflik-në*, *inat-në*, *djalë-n*, *burë-n*.

23.1. Emrat me temë më bashkëtingëllore marrin midis mbaresës *-n* dhe temës zanoren *-i-* ose *-u-*: *vënd-i-n*, *emër-i-n*, *trup-i-n*, *ulk-u-n* etj. Edhe emrat mashkullorë që mbarojnë me *-ë* të patheksuar, marrin *-i-* para mbaresës dhe humbasin *-ë-në*: *kal-i-n*, *djal-i-n*.

23.2. Në ndonjë rast këta emra marrin në kallzoren e shquar vetëm *-ë*, e cila vërtet është mbeturinë e mbaresës *-në* pasi *n-ja* është asimiluar me bashkëtingëlloren e temës, po sot ndihet si mbarese e pavarun, meqë haset dhe në ato raste ku nuk mund të kishim asimilim: *mori Sinanë /*, *o mirin miedhë /* «*miellin*», *ja dha hapsë /*, *o t i marim kuri-zë /*.

24. *Rrjedhorja*. Për t'u vënë në dukje është trajta e vjetër e rrjedhores me *-shit*, që haset te autorët e vjetër dhe aty këtu në ndonjë të folme të toskërishtes si relik, ndërsa këtu në frazeologjizmin «*i dodhi hundshit*».

E. Çabej në «Gjon Buzuku»<sup>19</sup> sjell nga Gjirokastra dhe këtë shëmbull «të iku balta këmbëshit».

25. *Gjindorja e dhanorja*. Emrat që dalin në shumës me bashkëtingëllore (kryesisht emra mashkullorë dhe ndonjë femëror) e formojnë trajtën e gjindores, dhanores dhe rrjedhores duke marrë vetëm mbaresën -e; trajta e shquar e këtyre rasave në më të shumtën e herëve dallohet nga trajta e pashquar, sepse marrin nyjën e mbrapme -t, po nuk janë të rralla dhe rastet kur nyja nuk çfaqet: «për kokën e *djemet*», e keshë të *kunetet*/», «në shtëpit e *kadëranjet* /», «jau shpinin *miqet* /», «u tha *djemet* /», «pas di *vjetet* /», «në të *vashazet* së tu!», «me lesht e *dhënet* /», «për kokën e *djemet*!», «si ajo e *karagjozate* /», «*djemet e shtrigjere* /», «pas dhjet *dite* /», «*damarët e duare* /».

### N y j a

26. Përsa i përket nyjës mund të bëhen këto vrejtje:

Në një togfjalësh: emër i gjinisë femërore të shquar që ndiqet nga një emër në gjindore a mbiemër, nyja e mbrapme -a nën ndikimin e nyjës së përparme e elidohet: këmb e parmëndës, te rëz e këmbës, Ar e Keçanje, kondoj e bardhë etj.

Nyja e përparme i e një emri në gjindore a e një mbiemri, që vinë pas një emri mashkullor të shquar me nyjë të mbrapme -i ose -u, nuk çfaqet: çarçafi jastëkut, dodhapi kafesë, te kreji këmbës, Çairi Musajt, djali madh etj.; jastëku krevatit, zogu natës, Bregu Honit, Bregu Madh, ibriku vogël, miku tij etj.

Gjithashtu nuk çfaqet nyja e përparme së e një emri në gjindore a e një mbiemri, që vinë pas një emri femëror në rasën gjindore, dhanore e rrjedhore të trajtës së shquar njëjës: i thua j nënës djalit /, qe një burë i bilës tetos time /, familjes tire /, pas gjishes tire / etj.

Në të gjitha rastet e tjera nyja e përparme çfaqet si në gjuhën e shkruar, por me ndryshimin që nyja e përparme së është përgjithësuar në gjindore dhanore e rrjedhore njëjës e shumës si në gjininë femërore dhe në mashkulloren: robot e atija së vdekurit /, është e çizmeve së Ziniut /, suratit së foshnjës /, i thotë së gjadhit / «të gjallit», i tha së madhit /, u ndajmë së rivet /, u thomi këtire së vogëlave /, o t ju puth dorën së gjithëvet /, u thotë së tërave /, ju ke dhënë së tjeravet, gjishen e babajt së këtire /, në të vashazet së tu /, këmbat e Mërzimit së Madh / (top.), djalit së vogël /, jastëku djepit së vogël /, pas zakonevet së para / etj.

Nga pikëpamja teritoriale ky fenomen nuk paraqitet dhe aq i kufizuar, e gjen veç Delvinës dhe Libohovës edhe në Lunxheri, Rrëzomë të Delvinës dhe Kardhiq, megjithse në këta dy të fundit është më i kufizuar, sepse nuk haset në të gjitha rastet që u përmendën më lart, psh. thuhet: atij së egërit /, maj veshit së djatht /, dhe në të së tjerëve /, po babait e Timos etj., ndërsa nuk haset në Rrëzën e Tepelenës, Kurvelesh, Kardhiq, Bregdet si dhe në Konispol e Mursi. Siç është vënë në dukje edhe në punimet për të folmen e Bregdetit<sup>20</sup> e Kurveleshit<sup>21</sup>, në këto krahina e

19) E. Çabej: «Gjon Buzuku» në Bul. për Shk. Shoq. 1955, 4, 118.

20) Punim i cituar 148

21) Punim i cituar (i pabotuar)

në ndonjë tjetër po përgjithësohet nyja e përparme *e*. Këtu nuk më duket se është e nevojshme të ndalem në hollësira, po është interesante të vihet në dukje që si në rastin e parë, si në të dytin del si prirje e përgjithshme e të folmeve nën Vjosë përgjithësimi i nyjës së përparme të gjinisë femërore.

### Përemrat

27. Përemri vetor veta e I rasa emërore njëjës del në trajtat *u* dhe *unë*. Nga këto dy trajta *unë* është më e rëndomtë, sidomos në brezin e mesëm e të ri. Ndryshime midis lagjeve për sa i përket përdorimit të tyre nuk vrehen, po në lidhje me vendin e tyre në fjali mund të thuhet se trajta *unë* përdoret më shumë para foljes, ndërsa *u* pas saj, po për këtë rregull që mund të ketë qenë më i qëndrueshëm, sot mund të flitet në përgjithësi, sepse rastet e kundërta, sidomos për trajtën *unë*, nuk janë të paka: *unë* nuk mbaj mënt /, *unë* kurë s'kam dalë /, ti veje / *unë* veja //, kam pasur bulqësi të madhe *unë* /, s e di *unë* këtë /, s i di fare *u* ato /, ku di *u* /, i thaçë *u* /, *u* jam bila tënde /.

Në shumës të rasës emërore përdoren trajtat: *neve*, *nevet* dhe *ne*. Trajtat *neve*, *nevet* kanë një përdorim shumë më të madh se *ne*: *neve* s i haritëm ato /, *neve* flasëm këtë /, *nevet* me këtë jemi /, thomi *neve*, i kriem *neve* /, doj të mirim *nevet* /, këto donim *nevet* /, *ne* pleqësia e parë kështu i thoshimë /, ç bëjmë *ne* / etj.

Në dhanore shumës përdoren trajtat *neve* dhe *nevet*: na bënesh birëku i mirë *neve* /, ish atje karshi *nevet* /, ndërsa në kallzore trajtat *neve*, *nevet* dhe *ne*: *neve* na kanë pohtisur /, haj me *nevet* /, për *ne* u shkrua / etj.

Në vetën e II njëjës si emërorja dhe kallzorja kanë trajtën *ti*: *ti* veje / *unë* veja //, si o të njoh *u* *ti* // etj. Në emërore ndihet ndonjëherë dhe trajta *tinë*: që the *tinë* /.

Në shumës rasa emërore përdoren trajtat *juve* dhe *juvet*, ndërsa nuk e kam hasur trajtën «ju»: kur të bëni dhe *juve* si *neve* /, atë kërkoni *juvet* /, ndërsa në kallzore trajtat: *juve* (?), *juvet* dhe *ju*: për *juvet* /, *ju* kam *ju* /.

Në vetën e III njëjës rasa emërore gjinia mashkullore përdoren trajta *ai* dhe *ainë*: e kuptoi *ai* /, e puthi *ainë* /. Gjinia femërore ka trajtën *ao* që ndihet zakonisht, dhe *ajo*: *ao* ka pesë xhepa /, pse dhe *ao* të lipset?, hajde të t i apë *ao* /, iku *ajo* /.

## 27.1. Trajtat e përemrit dhe mbiemrit pronor janë:

		Veta e parë		Veta e dytë	
		Gj. mashk.	Gj. fem.	Gj. mashk.	Gj. fem.
Pronari njëjës	Prona njëjës	timi, kokoshi tim timit, kokoshit tim timin, kokoshit tim.	timja, pula time times, pulës time timen, pulën ime.	tëndi, kokoshi tënd tëndit, kokoshit tënd tëndin, koko hin tënd	tëndja, puna tënde tëndes, pulës tënde tëndën, pulën tënde.
	Prona shumës	të mitë, kokoshët e mi së mivet, kokoshëvet së mi.	të mitë, pulat e e mi së mivet, pulvet së mi.	të tutë, kokoshët e tu së tuvet, kokoshëve së tu.	të tutë, pulat e tu së tuvet, pulavet së tu.
Pronari shumës	Prona njëjës	toni, kokoshi tonë tonit, kokoshit tonë tonin, kokoshin tonë.	tona, pula tonë tonës, pulës tonë tonën, pulën ton	tuaji, kokoshi tuaj tuajit, kokoshit tuaj tuajin. kokoshin tuaj.	tuaja, pula tuaj, tuajës, pulës tuaj tuajën, pulën tuaj.
	Prona shumës	tonët, kokoshët tonë, tonëvet, kokoshëvet tonë.	tonat, pulat tona tonavet, pulavet tona.	tuajt, kokoshët tuaj tuajvet, kokoshëve tuaj.	tuajt, pulat tuaj tuajvet, pulavet, tuaj.

Nga tabela e mësipërme del që në të folmen e Gjirokastrës është arritur një thjeshtim i madh i trajtave të përemrave dhe mbiemrave pronorë të vetës së I dhe të II. Këtu është përgjithësuar për të gjitha rasat e tjera trajta e rasës kallzore. Përemri pronor i vetës së I dhe të II pronas shumës pronari njëjës gjinia femërore paraqitet në trajtën e tij të vjetër, të padiferencuar nga trajta e mashkullores; kështu paraqitet ai edhe në të folmen e Lunxherisë. Po, nëqoftëse në këtë pikë që përbën një konservim, e folmja e Gjirokastrës gjen një shoqe në të folmet që e rrethojnë, në inovacionet e saj (në thjeshtimin e trajtave të mbiemrave pronorë nëpërmjet përgjithësimit të trajtës së kallzores) mbetet e vetme, e izoluar. Larg saj, në të folmen e Përmetit e të Korçës trajtat e përemrit dhe mbiemrat pronor veta e I dhe e II pronas dhe pronari njëjës, me përjashtim të përdorimit para emrave të farefisnisë, gjithashtu janë thjeshtuar. Këtu duket që kemi të bëjmë me një inovacion më shumë qytetar.

Para emrave të farefisnisë në të folmen e Gjirokastrës pronorët nuk përdoren.

Trajta të tilla si *im*, *ime*, të dëgjua nga një grua që banon në Tiranë, duhen pranuar si ndikime.

27.2. Për përemrin dhe mbiemrin dëftor *ai*, *a(j)o* mund të thuhet po ato gjëra që janë thënë dhe për përemrin vetor *ai*, *a(j)o*. Këtu duhet shtuar se edhe përemrat dhe mbiemrat dëftorë që tregojnë diçka të afërt, shpesh përdoren në emërore njëjës në trajtën e zgjeruar me *-në*: *kinë*, *kjonë*: i thotë *kjonë /*, *kjo* është punë për mua, *tha kinë /*.

## Folja

28. Në sistemin foljor e folmja e Gjirokastrës paraqitet me një sërë tiparesh që e dallojnë nga e folmja e Konispolit e sidomos nga e folmja e Kurveleshit. Mbaresat e vjetra kanë pësuar ndryshime fonetike, rezultat i të cilave ka qenë rrafshimi i formave që në një periudhë më të hershme dalloheshin mirë njera nga tjetra; kjo, nga ana tjetër, ka dhënë shkas për përdorimin e mbaresave të tjera. Këtu edhe tema e foljeve pëson në zanoret e theksuara po ato ndryshime që pëson edhe në gjuhën e shkruar, gjë që nuk ndodh në të folmet që përmendëm më lart. Karakteristike për këtë të folme është përdorimi, në disa raste, i mbaresave paralele që pasqyrojnë një fazë kalimtare, fazën e përgjithësimit të mbaresave të reja. Në disa nga këto raste ndikimi i gjuhës së shkruar është i qartë.

29. *E tashmja e dëftores.* Foljet e zgjedhimit të II klasa e I<sup>22</sup> dalin më -t e cila ruhet gjatë gjithë fleksionit të këtyre foljeve: *zbut, dorovit, këput, këput, këput, këputim, këputni, këputin* / edhe e pakryer *këputij* etj. Po kështu edhe foljet e klasës së II në vetën e II shumës dhe në të pakryerën kanë t e jo s : *flas, flet, flet, flasim, flitni, flasin* /, *flitij* etj.

Foljet me temë më bashkëtingëllore marrin në shumës mbaresat -im, -ni, -in: *krip-im, krip-ni, krip-in* //, *dredh-im, dridh-ni, dredh-in* //, *vras-im, vrit-ni, vras-in* //. Krahas këtyre mbaresave që janë më të rëndomtë, hasen për vetën e I e të III edhe mbaresat: -ëm e -ën, të cilat në të folmen e Kurveleshit janë të vetmet: *përdor-ëm, qeth-ëm, flas-ëm, përdor-ën, dal-ën*. Përdorimi i këtyre dy llojeve mbaresash është karakteristike e disa të folmeve të krahinave lindore të trevës në të majtë të Vjosës, ku përfshihen edhe Zagoria, Lunxheria, Delvina e Konispoli. Po në dallim nga e folmja e Zagorisë dhe e Lunxherisë, ku këto mbaresat kanë një përdorim të përcaktuar (-im etj. përdoret me foljet, tema e të cilave në të tashmen dhe në të kryerën e thjeshtë nuk ndryshon, ndërsa -ëm me foljet, tema e të cilave në të kryerën e thjeshtë pëson ndryshime) këtu, siç e tregojnë dhe shembujt, s'ka një rregull të tillë; në ato pak raste që hasen, përdoren me folje të të dyja grupeve. Në rrugën drejt përgjithësimit të mbaresave -im, -in e folmja e Gjirokastrës ka shkuar më përpara se të folmet që u përmendëm më lart, ajo ndodhet në fundin e kësaj rruge.

29.1. Foljet e zgjedhimit të III marrin në shumës mbaresat: -jmë, -ni, -jnë : *la-jmë, la-ni, la-jnë* //, *zie-jm, zie-ni, zie-jn* //. Trajta -i e mbaresës së vetës së II këtu thua se nuk përdoret fare; e kam hasur vetëm një herë: *thoji* «thoni».

29.2. Foljet «kam» e «jam» në vetën e II shumës kanë trajtën: *keni, jeni* e jo *kini, jini* si në të folmet e tjera të Labërisë.

30. *E pakryera.* — Lidhur me çështjen se a ndryshon zanorja e rrënjës gjatë zgjedhimit të foljes në të pakryerën, të folmet e trevës në të majtë të Vjosës ndahen. Të folmet e pjesës veriperëndimore, duke futur këtu dhe atë të krahinës së Lopsit (Tepelenë), e ndryshojnë; pjesa tjetër e të folmeve, më e madhja (e folmja e Mesaplikut, e Kurveleshit, e Rrëzës së Tepelenës, e Zagorisë, e Kardhiqit, e Rrëzomës, e Bregdetit dhe e Konispolit) nuk e ndryshojnë. Gjirokastra bashkë me Libohovën dhe Delvinën, që në këtë pikë afrohen me të parën, nga pikëpamja e teritorit janë të ndara prej saj dhe gjenden në mes të së dytës. Po e theksoj këtë, sepse, nëqoftëse nga sistemi i mbaresave kjo e folme dallohet ose afrohet

22) Klasifikimi i foljeve do të bëhet sipas K. Cipos në *Gramatika shqipe (Morfologjia)*.

me të folmen e kësaj ose asaj krahine që e rrethon, nga ndryshimi i zanores së rrënjës në të pakryerën largohet prej të gjithave. Po të nisemi nga pozita gjeografike, ndrimi i zanores së rrënjës në këto të folme del si një inovacion i izoluar, i cili nuk duket të jetë shumë i lashtë. Për këtë flet si e folmja e Lunxherisë, ku fenomeni nuk është përgjithësuar në vetën e I e të II njëjës, nga një anë, dhe fakti tjetër që edhe në Gjiro-kastër në të folmen e brezit të vjetër përdoren aty këtu trajta pa zanoren e rrënjës të ndryshuar si: *shojë, vdesijn, pjekijn*, të cilat në Delvinë janë më të shpeshta.

30.1. Si kudo në të folmet e trevës në të majtë të Vjosës dhe këtu e pakryera dallohet për një larmi formash që e kanë burimin jo vetëm te zgjedhimet e grupet e ndryshme të foljeve, po sidomos te përdorimi i dy ose tri mbaresave paralele.

Mbaresat më të rëndomta për foljet me temë më bashkëtingëllore janë: njëjës v. I *-ij*, II *-je*, III *pa mbaresë*, shumës v. I *-im*, II *-it*, III *-in*.

*kudhos-ij, kudhos-je, kudhos, kudhos-im, kudhos-it, kudhos-in //*  
*shkel-ij, shkel-je, shkel, shkel-im, shkel-it, shkel-in //*  
*mir-ij, mir-je, mir, mir-im, mir-it, mir-in //*  
*dridh-ij, dridh-je, drith, dridh-im, dridh-it, dridh-in //*  
*prit-ij, prit-je, prit, prit-im, prit-it, prit-in // etj.*

30.1.1. Për foljet me temë më zanore janë: njëjës v. I *-jë*, II *-je*, III *-n*, shumës v. I *-jmë*, II *-jtë*, III *-jnë*.

*bë-jë, bë-je, bë-n, bë-jmë, bë-jtë, bë-jnë //*  
*qa-jë, qa-je, qa-n, qa-jmë, qa-jtë, qa-jnë //*  
*lie-j, lie-je, lie-n, lie-jm, lie-jt, lie-jn //*  
*pi-jë, pi-je, pi-n, pi-jmë, pi-jtë, pi-jnë //*  
*zi-jë, zi-je, zi-n, zi-jmë, zi-jtë, zi-jnë //*  
*shpi-jë, shpi-je, shpi-n, shpi-jmë, shpi-jtë, shpi-jnë // etj.*

Për analogji me këto shpesh zgjedhohen kështu edhe foljet «shoh» e «njoh», bashkëtingëllorja *-h* e të cilave ndihet mjaft dobët ose nuk ndihet fare, kështu që dalin me temë me zanore: *shihij* etj. dhe *shojë, shin, shijmë* etj., *njihij* etj. dhe *njojë, njin* etj.

30.1.2. Foljet ndihmëtare marrin këto mbaresa: njëjës v. I *-ë*, II *-e*, III *pa mbaresë*, shumës v. I *-më*, II *-të*, III *-në*. Këtu është e domosdoshme të theksojmë që këto dy folje në vetën e I e të II njëjës, ndonjëherë dhe në shumës, nuk e ndryshojnë zanoren e rrënjës.

*kesh-ë, kesh-e, kish, kish-më, kish-të, kish-në //*  
*jesh-ë, jesh-e, ish<sup>23</sup>, jesh-më, jesh-të, jesh-në //*

30.2. Krahas këtyre, po më të rralla në përdorim, ndeshen edhe mbaresa të tjera:

Në vetën e I njëjës: *-a* në foljet ndihmëtare: *kesh-a, jesh-a* (këto folje marrin edhe mbaresën *-ij*: *këshij, jeshij*); *-ja* në të gjitha të tjerat:

23) Trajtat e vetës së III njëjës dhe të shumësit të së pakryerës së foljes «jam» janë pak të përdorshme. Në vend të tyre sot përdoren trajtat e vetave përkatëse të së kryerës së thjeshtë, ashtu si përdoren dy vetat e para të njëjësit të kësaj kohe për vetat përkatëse të së kryerës së thjeshtë.

*përqesh-ja, mbush-ja, mir-ja, hidh-ja, ik-ja, flit-ja, bë-ja, li-ja, ngarko-ja, rua-ja, di-ja, li-ja* etj. *-ija* vetëm në foljet me temë më bashkëtingëllore: *shit-ija, prit-ija*. Nga këto mbaresa *-ija* është mjaft e rrallë, e kam hasur në nja tri raste, ndërsa *-ja* del më shpesh në foljet me temë më zanore. Për të pasur më të qartë përdorimin e mbaresave të vetës së I, po paraqes një statistikë, e cila, megjithse subjektive, e plotëson deri diku tabllonë e mësipërme. Kështu mbaresa *-ij* është përdorur 45 herë, *-jë* 41 herë nga të cilat 10 herë në foljet me temë më bashkëtingëllore dhe 15 herë në ato më zanore, *-ija* 3 herë, *-ë* 11 herë, *-a* 2 herë. Po ta shohim përdorimin e mbaresave *-ij* dhe *-jë*, nga një anë, dhe *-ja, -ija*, nga ana tjetër, tek disa subjekte, do të kemi këto rezultate: S. 4 — 7/1, S. 8 — 11/0, S. 9 — 2/0, S. 14 — 2/3, S. 10 — 0/11.

30.2.1. Në vetën e III njëjës përdoret në një masë më të vogël edhe mbaresa *-te*: *stolis-te, ik-te, hap-te, vidh-te, hidh-te, shit-te, flit-te* (në foljet me temë më *-t t-ja* e mbaresës është shkruar me *t-në* e temës e sot ndihen si një tingull i vetëm i gjatë), *dëgjon-te, han-te, bluan-te, rin-te, pin-te, shpin-te* etj. *-tej* vetëm një rast: *prit-tej*, gjithashtu vetëm në dy raste janë ndeshur krahas trajtave me *-n* edhe trajtat me *-j*, që janë aq të rëndomta në Kurvelesh e Bregdet: *ha-j* dhe *shti-j*. Raporti i përdorimit të trajtave pa mbaresën *-te* dhe me *-te* është 80/45 (në foljet me temë më bashkëtingëllore 37/14 dhe në ato më zanore 43/31, raport që tregon për një përdorim më të madh të mbaresës *-te* në foljet me temë më zanore), ndërsa te subjekte të veçanta është i tillë: S. 5 — 31/0, S. 8 — 10/0, S. 14 — 1/7, S. 10 — 2/7.

30.2.2. Në shumësin e foljeve me temë më bashkëtingëllore përdoren edhe mbaresat: v. I *-ijm(ë)*, II *-ijt(ë)* (?), III *-ijn(ë)*: *vidh-ijm, hidh-ijm, hap-ijn, mir-ijnë, shtip-ijnë, mblihd-ijnë, pjek-ijnë, thosh-ijnë, vdes-ijn, ip-ijn, prit-ijn, shit-ijn*. Me përjashtim të shembullit të fundit, të gjithë të tjerët janë dëgjuar prej S. 8, më i moçmi, tek i cili raporti i shembujve me *-im* etj. dhe *-ijm* etj. është 6/13. Në shumësin e foljeve me temë më zanore hasen fort rrallë edhe mbaresat: I *-nim*, II *-nit* (?) III *-nin*: *di-nim, bë-nin, mba-nin, vi-nin, shpi-nin*.

30.3. Po ta shohim çështjen e formimit të së pakryerës në këtë të folme nga pikëpamja historike, del që mbaresat më të vjetra janë: njëjës v. I *-ë*, II *-e*, III-, shumës v. I *-më*, II *-të*, III *-në*. Kjo gjë bëhet e qartë si nga autorët e vjetër (Buzuku për njëjësin) dhe nga të dhënat e të folmeve fqinje e të vetë kësaj së folmeje. Këto mbaresa si të tilla këtu dalin vetëm në foljet ndihmëtare. Në foljet e zgjedhimit të III këto mbaresat i janë ngjitur një teme që del e njëjtë me trajtën e së tashmes v. I. Me kohë bartësi i kësaj së folmeje i lidhi ato me *-j-në* e temës dhe i kuptoi të dyja si mbaresë, ndoshta nga që në v. e III njëjës nuk dilte kjo *j*. Si e tillë (pra *-jë, -je* etj.) ajo u shtri për analogji në foljet me temë më zanore të tipit *pi, zë* dhe në ato me temë më bashkëtingëllore, në vetën e I njëjës të të cilave lindi një *i* anaptitike, me sa duket, për shkak të karakterit të paqartë të zanores *ë* të mbaresës *-jë*<sup>24</sup>.

Mbaresat *-ja* ka një përdorim të kufizuar në këto anë. E gjen pak më shpesh në Delvinë, po në Zagori dhe Lunxheri të kufizuar në brezin e ri e të mesëm të shkolluar, kurse në krahinat e tjera më të veçuara nuk ndihet. Ky fakt si dhe fakti tjetër, për të cilin është folur më lart në 30.2.,

24) Lindja e një *i-je* para një *jë-je* që vjen pas një bashkëtingëllores ose *ë-je*, është e përgjithshme në këto anë dhe vrehet edhe në emrat e tipit *vdek-i-j* «vdekje» nga «vdekëlë, vdeklë» etj.

të shtyjnë të pranosh që këtu kemi të bëjmë me një ndikim të gjuhës së shkruar, po në këtë mes duhet venë në dukje një gjë interesante: kontaminimi në disa raste i mbaresës *-ij* me *-ja* prej nga ka dalë mbaresa *-ija*. Edhe mbaresa *-te* e vetës së III po për këto arsye del që është një ndikim i vonë, i këtij shekulli, i gjuhës së shkruar se sa një zhvillim i brendshëm, i hershëm i kësaj së folmeje.

Për sa i përket shumësit, në trajtat me *-ijm(ë)* etj., të cilat nuk i kam ndeshur në asnjë të folme tjetër të kësaj ane, duhet parë një fazë më e vjetër e trajtave me *-im* etj. Sonantja *j* e mbaresave *-ijmë* etj. është asimiluar nga zanorja *i*, pra *-ijmë* : *-imë* : *-im* etj.

31. *E kryera e thjeshtë*. — Mbaresat më të përgjithshme janë: njëjës v. I *-a*, II *-e*, III *-i* (e cila në foljet me temë më zanore është shndruar në *-j*) dhe *-u*, shumës v. I *-më* II *-të*, III *-në*:

*ther-a, ther-e, ther-i, ther-më, ther-të, ther-në* //  
*pandeh-a, pandeh-e, pandeh-u, pandeh-më, pandeh-të,*  
*pandeh-në* //  
*mblodh-a, mblodh-e, mblodh-i, mbluadh-m (dhe mblodh-më),*  
*mbluadhtë, mbluadh-në (dhe mbluadh)* //  
*blo-v-a, blo-v-e, blo-j, blua-m, blua-t, blua-n* //  
*haro-v-a, haro-v-e, haro-j, harua-m, haria-t, harua-n* //  
*bër-a, bër-e, bër-i, bë-më, bë-të, bë-në* //  
*la-v-a, la-v-e, la-u, la-më, la-të, la-në* //

Krahas këtyre mbaresave hasen edhe mbaresa të tjera, të dyta, të cilat në këtë ose atë grup foljesh janë më të përhapura e ndonjëherë sundonjëse.

31.1. Folja «gjej» si në mbarë shqipen del në tri vetat e njëjësit me mbaresat v. I *-ta*, II *-te*, III *-ti* pra: *gjeta, gjete, gjeti*. Siç dihet, këto mbaresat janë formime analogjike nga e kryera e thjeshtë e foljeve të zgjedhimit të II më *-t*. Këto mbaresat këtu përdoren edhe në disa folje të tjera, mjaft të kufizuara në numër si: *mbruj, vete* etj. *mbrujta, mbrujte, mbujti* //, *vajta, vajte, vajti* // . M. Domi *j-në* që del te këto, e shpjegon me faktin se «kjo trajtë është formuar mbi temën e së tanishmes ashtu si paraqitet ajo në vetën e parë njëjës»<sup>25</sup>. Ky shpjegim duket se nuk është fort bindës, meqë atëherë në shumë të folme që e ruajnë *nj-në* në vetën e parë si në Përmet etj. duhet të kishin *nj* e jo *j*. Një ndrim i *nj-së* në *j* para *t-së* gjithashtu nuk mund të pranohet, po të kemi parasysh trajtat : ndënjta; ndënjte, ndënjti që hasen ende në shumë të folme ku *nj-ja* në të tashmen është ndruar në *j*. Mendoj që veta e III njëjës, që është bërë shkak edhe për ndryshime të tjera, të ketë ndikuar edhe këtu. Sot në të folmen e Gjirokastrës ashtu si dhe në atë të Përmetit të gjitha foljet me temën e së kryerës së thjeshtë me zanore dalin edhe në një trajtë me mbaresën *-jti*, e cila, nga ana tjetër, më rezulton si më e rëndomta në krahasim me mbaresën *-j* e *-u*: *turpëro-jti, shko-jti, fidho-jti, mbaro-jti, nda-jti, shka-jti, qa-jti, la-jti, kre-jti, pëlqe-jti, pi-jti, shti-jti, pre-jti* etj. Kjo mbaresë ka zënë fill në foljet me *-oj* si punoj etj. Meqë mbaresat *-i* për arsye fonetike u ndrua në *-j* e meqë vlera e kësaj *-j-je* si mbaresë filloi të humbasë, u shtri për analogji *-ti*. Prej këtej në formën *-jti*, pra si mbaresë dyfishe, u përhap edhe në foljet e tjera që e bëjnë vetën e III me *-u* si *lau-lajti, preu-prejti*. Kjo trajtë e vetës së III, besoj, ndikoi edhe në vetën e I e të II

25) M. Domi *Morfologjia historike e shqipes* (Konspekt leksione), 1961, 62.

të njëjësit të atyre pak foljeve që përmendëm më lart, dhe përgjithësisht për tri vetat e shumësit, për të cilat do të flitet më poshtë.

31.2. Foljet e zgjedhimit të IV klasa e II në vetën e III ashtu si dhe në vetat e tjera të njëjësit nxjerrin *r*-në e temës së vjetër dhe marrin mbaresën *-i*: *shtur-i*, *prur-i*, *zur-i*, *shpur-i*, *vur-i*, po kështu dhe *bër-i*, *hir-i*. Vetëm në një rast është dëgjuar trajta pa mbaresë e v. së III të këtyre foljeve: më *zu* tedhua //.

31.3. Në shumës foljet me temë më bashkëtingëllore shumë rrallë gjenden dhe me mbaresën *-ëm* (?), *-ët*(?)<sup>26</sup>, *-ën*, të cilat, po t'i gjykojmë nga rrallësia e përdorimit dhe nga brezat që i përdorin, dalin si ndikime të gjuhës së shkruar: *ther-ën*, *prit-ën*, *ngrit-ën*, *hëngr-ën*. Përkundrazi foljet me temë më zanore dalin më shumë me mbaresat *-jtim*, *-jtiti*, *-jtin*: *shkrua-jtim*, *shkrua-jtiti*, *shkrua-jtin* //, *ça-jtim*, *ça-jtiti*, *ça-jtin* //, *pi-jtim*, *pi-jtiti*, *pi-jtin* //, *pre-jtim*, *pre-jtiti*, *pre-jtin* //, gjithashtu *hi-jtim*, *bë-jtim* etj. Foljet e zgjedhimit të IV klasa e II nuk hasen me këto mbaresa në shumës, pra vetëm: *vu-më*, *vu-të*, *vu-në* //, *pru-më*, *pru-të*, *pru-në* // etj. Siç e kam thënë dhe në një punim tjetër trajtat me mbaresat *-jtim* etj. janë formuar në bazë të analogjisë me vetën e tretë njëjës, e cila është marrë si temë e këtyre trajtave. Shumë rrallë janë hasur dhe trajta të tilla të shumësit të foljeve më zanore si: *qajtën*, *pijtën*.

31.4. Një kategori foljesh e bëjnë vetën e parë njëjës me aorist sigma-tik: *thaçë*, *dhaçë*, *laçë*, *paçë* «pashë», *mbeçë* «mbetshë», *gjeçë* «gjjetshë», *paçë* «patshë».

32. Trajta e rëndomtë e së ardhmes është ajo që formohet nga e tashmja e lidhores me pjesëzën *o* e cila është rezultat i reduktimit të *do-së*: *ç o t them*, *o t i humbç*, *o të bëjë*, *o t marim*, *o të flëmë* etj. Në shumë raste pjesëza të e lidhores nuk ndihet: *o vi*, *o laj*, *o ngrihem*, *ç o më japç*, *o vejë*, *o ven* etj. Pjesëza të përdoret rregullisht, kur folja shoqërohet nga trajtat e shkurtëra të përemrave vetorë *e*, *i* ose pjesëza *u* e diatezës pësore-vetvetore.

33. *E tashmja e lidhores*. Në vetën e II njëjës si foljet me temë më bashkëtingëllore, si ato më zanore marrin mbaresën *-ç*: të *njgjeç* «të ngjeshç», të *hedhç*, të *març*, të *pieç* «të pyeshç», të *japç*, të *kuptoç*, të *bëç*, të *mbaç*, të *duaç* etj. Në ndonjë rast para mbaresës del një *-i*- epentetike: të *ritiç*. Gjithashtu në nja dy raste është dëgjuar mbaresa *-sh* në folje me temë më zanore: të *duash*, të *shtiesh*.

33.1. Foljet me temë më bashkëtingëllore, foljet e zgjedhimit të I e të II e bëjnë vetën e III me tri mbaresa : *-ë*, *-i* dhe *-ij(ë)*. Mbaresa *-ë* është pak më e përhapur: të *lidh-ë*, të *potis-ë*, të *mar-ë*, të *dal-ë*, të *mbledh-ë*, të *djeg-ë*, të *pres-ë*, të *vdes-ë* etj. Me këtë mbaresë, po duke nxjerrë *r*-në e temës së vjetër, e bëjnë vetën e III dhe disa folje të zgjedhimit të IV klasa e II: të *bjer-ë*, të *shpjer-ë*.

33.1.1. Jo të paka janë rastet kur folje me temë më bashkëtingëllore dalin në këtë vetë me mbaresën *-i*: të *shkund-i*, të *psonis-i*, të *palos-i*, të *mar-i*, të *dal-i*, të *heq-i*, të *flas-i*, të *thëres-i*, të *jap-i* etj. Folje të zgjedhimit të IV klasa e II me këtë mbaresë nuk kam dëgjuar.

33.1.2. Mbaresa *-ij(ë)* është e rrallë, megjithse nuk është as e kufizuar në lagje e as në breza (e kam dëgjuar dhe në të folmen e brezit të ri). Duket që kemi të bëjmë me një riformim të vonë në bazë të analogjisë me

26) Për dy vetat e para nuk kam regjistruar shembuj, po, meqë për vetën e III kemi *-ën*, sado rrallë, duhet që të përdoren dhe ato.

foljet e zgjedhimit të III, ku mbaresa -jë u ngjitet trajtave me mbaresën -i: të lidh-ij, të mar-ij, të flas-ijë, të jap-ijë.

Po të bëjmë një statistikë të përdorimit të këtyre mbaresave në foljet e zgjedhimit të I e të II, do të kemi këto rezultate: me -ë, 25, me -i 17 me -ij(ë) 5.

33.1.3. Foljet e zgjedhimit të III dhe të IV klasa e I dhe disa të klasës së II marrin mbaresën -jë: të shko-jë, të ble-jë, të bë-jë, të ha-jë, të ve-jë, të ngre-jë, të vë-jë, të zë-jë, etj., gjithashtu dhe të sho-jë, të njo-jë krahas të shoh-ë, të njoh-ë.

34. E tashmja e dëshirores. — Foljet e zgjedhimit të I e të II, përgjithësisht foljet që dalin me temë më bashkëtingëllore në të kryerën e thjeshtë, marrin në të tashmen e dëshirores mbaresat: njëjës v. I -ça, II -ç, III -të, shumës v. I -çim, II -çi, III -çin:

vdek-ça, vdek-ç, vdek-të, vdek-çim, vdek-çi, vdek-çin //  
 hangër-ça, hangër-ç, hangër-t, hangër-çim, hangër-çi,  
 hangër-çin //  
 pa-ça «pat-sha», pa-ç, pas-të, pa-çim, pa-çi, pa-çim //  
 mun-ça «mundsha», mun-ç, mun-të, mun-çim; mun-çi,  
 mun-çin //

Foljet që dalin me temë më -sh, e humbasin atë para mbaresave që nisin me ç: mbu-ça, «mbush-ça», mbu-ç, mbush-të, mbu-çim, mbu-çi, mbu-çin //.

Foljet me temën e së kryerës së thjeshtë më zanore marrin këto mbaresat: njëjës v. I -fça, II -fç, III -ftë, shumës v. I -fçim, II -fçi, III -fçin:

ro-fça, ro-fç, ro-ftë, ro-fçim, ro-fçi, ro-fçin //  
 shko-fça, shko-fç, shko-ftë, shko-fçim, shko-fçi, shko-fçin //

Disa nga këto folje dalin në dëshërore edhe me një trajtë tjetër. Mbaresat e këtyre trajtave dalin të njëjta me ato të foljeve më bashkëtingëllore, kurse zanorja e rrënjës o del e zberthyer në ua: (më) ruaç, (të) ruatë, (më) ruaçi, (të) ruaçin, gëzuaçi. Këto trajta janë të kufizuara dhe kanë një përmbajtje emocionale më të madhe se trajtat e tjera. Në vetën e parë sikur nuk përdoren.

Lidhur me të tashmen e dëshërores janë për t'u vënë në dukje këtu tri gjëra: e para, që sh-ja e mbaresave është kthyer përgjithësisht në ç e vetëm në ndonjë rast sporadik ruhet: pafsha, pafsh, hëngësh; e dyta, që kjo ç pas f-së aty këtu në vetën e I dhe të II nuk ndihet: të bëfa gropën!, të vufa në dhe!, të dhjefa!, dëgjofa, rof e trashëgof!, qof shëndoshë!; e treta, që në krahasim me të folme të tjera tema e disa foljeve në dëshërore është e ndryshme; kështu foljet: gjej, arij, roj, vete, vë, bie (prura), rah (dhe ra) e formojnë dëshëroren nga një temë më zanore, së cilës i ngjiten mbaresat -fça etj. Kjo temë në disa raste nuk është plotësisht e njëjtë me atë të së kryerës së thjeshtë: gjej, gjeta — gjefça; arij, arita — arifça; roj, rova — rofça; vete, vajta — vafça; vë, vura — vufça; bie, prura — prufça; rah(ra), raha (rava) — rafça.

35. Urdhërorja. — Përgjithësisht formohet si në mbarë shqipen, vetëm një numër i vogël foljesh paraqesin interes dialektor, sidomos për sa i përket temës.

Disa folje dalin në vetën e II njëjës me mbaresën -ë: mos folë!, ikë!, mos thirë! mos shpjerë! krahas mos e shpjer!

Foljet «ngas» dhe «vras» nuk e ndrojnë zanoren e temës: mos e *nga!* mos e *vra!* dhe në shumës *ngani*, *vrani*, po «thres» e bën *thirë*, shumës *thirni*.

Folja «bëj» ka në urdhërore trajtën: *bën* «*bën ç kanë bënë gjithë bota!*», shumës *bëni*.

Foljet «lë» dhe «zë» kanë trajtat: *le* «*le mos i folë!*», *ze* dhe në shumës *leni*, *zeni*. Kur pas këtyre përdoren trajtat e shkurtëra të përemrave, midis temës dhe mbaresës del një *j* antihiatizuese: *le-j-e*, *ze-j-e*, *le-j-eni*, *ze-j-eni*. Trajta të tilla: *lere*, *zere*, *lereni*, *zereni* të urdhërores së këtyre foljeve, janë të rralla e duket që janë ndikime të të folmeve të tjera.

Foljet «bie», «shpie», «shtie» në urdhërore njëjës dalin me temën e vjetër me *-r* dhe nuk marrin mbaresë; si në njëjës dhe në shumës togu zanor *ie* është ndruar në *je*: *bjer*, *shpjer*, *shtjer*. Kur pas tyre përdoren trajtat e shkurtëra *na*, *më* nuk çfaqet *-r*-ja: *bjemë*, *bjena*, *shpjem* etj.

Midis temës së foljeve të zgjedhimit të III dhe trajtave të shkurtëra *i,e* dhe pjesëzës *u*, kur përdoren në enklizë, del një *j* eufonike: *zbulo-j-e*, *zgjo-j-e*, *kre-j-e*, *prë-j-u* etj.

36. *Pjesorja*. — Edhe në këtë pikë e folmja e Gjirokastrës dallohet shumë nga e folmja e Kurveleshit.

Foljet që dalin në të kryerën e thjeshtë me temë më bashkëtingëllore, me përjashtim të atyre që dalin me *l*, *dh* (<ll) e *r* dhe që e ndryshojnë temën, marrin në pjesore mbaresën *-ur*: *hap-ur*, *rah-ur*, *lind-ur*, *fut-ur*, *rit-ur*, *pjek-ur*, *pat-ur*, *ngrit-ur*, *vajt-ur*, *mbajt-ur*, *harit-ur* etj. Me këtë mbaresë e bëjnë pjesoren edhe foljet me temë më *l*, *dh* (<ll) e *r*, po që nuk e ndryshojnë temën në të kryerën e thjeshtë: *ngul-ur*, *fol-ur*, *mbidh-ur* «mbyllur», *njgjadh-ur*, *kadh-ur*, *var-ur*, *ther-ur*, *kor-ur*, *përdor-ur* etj.

Foljet më *l*, *dh* (<ll) e *r*, që e ndryshojnë temën në të kryerën e thjeshtë marrin mbaresën *-ë*: *dal-ë*, *pjedh-ë*, *mar-ë*, *çjer-ë*, *tjer-ë*, *nxier-ë* etj.

Foljet me temë më zanore në të kryerën e thjeshtë v. I, marrin mbaresën *-r(ë)*: *hi-rë*, *ngri-rë*, *ngarkua-r*, *kapërcie-r*, *krie-r* etj.

Foljet e zgjedhimit të IV klasa e II marrin mbaresën *-në*: *lë-në*, *rë-në*, *ngrë-në*, *vë-në*, *zë-në*, *thë-në*, gjithashtu *që-në*. Në analogji me këto e bën pjesoren edhe folja «bëj»: *bë-në*.

Foljet «shpie», «shtie», «bie» kanë në pjesore një temë të njëjtë me atë të së kryerës së thjeshtë dhe marrin mbaresën *-ë*: *shpur-ë*, *shtur-ë*, *prur-ë*.

37. *Trajtat e foljeve të diatezës pësore, vetvetore e mesore*. Në të tashmen e dëftores këto folje marrin mbaresat: njëjës v. I *-em*, II *-e*, III *-et*, shumës v. I *-emi*, II *-eni*, III *-en*. Në foljet më *-oj*, *-ej* dhe *-ëj* midis temës dhe mbaresës del një *n*. Po shpesh edhe te këto bashkëtingëllores *-n* zëvendësohet nga një *-h-* antihiatizuese, e cila është e zakonitë për foljet e tjera me temë më zanore. Disa folje të zgjedhimit të IV klasa e II dalin me temën e vjetër më *-r*. Zanorja e rrënjës ndryshon si në gjuhën e shkruar:

*fut-em*, *fut-e*, *fut-et*, *fut-emi*, *fut-eni*, *fut-en* //  
*bën-em*, *bën-e*, *bën-et*, *bën-emi*, *bën-eni*, *bën-en* //  
*zbru-h-em*, *zbru-h-e*, *zbru-h-et*, *zbru-h-eni*, *zbru-h-eni*,  
*zbru-h-en* //  
*zir-em*, *zir-e*, *zir-et*, *zir-emi*, *zir-eni*, *zir-en* //

38. Foljet e diatezës pësore, vetvetore e mesore në të pakryerën marrin këto mbaresa : njëjës v. I *-esh(ë)*, II *-eshe*, III *-esh*, shumës v. I *-eshm(ë)*, II *-esht(ë)*, III *-eshn(ë)*. Këto, me përjashtim të mbaresës së vetës së III njëjës, e cila është ndryshuar në bazë të analogjisë, si në mbarë shqipen<sup>27</sup>, dalin se janë të barabarta me trajtat e së pakryerës së foljes «jam» pa bashkëtingëlloren *j* (shih fq. 20).

Tema e kësaj kohe pëson po ato ndryshime që pëson edhe e tashmja:

*shkul-esh(ë)*, *shkul-eshe*, *shkul-esh*, *shkul-eshm(ë)*, *shkul-esht(ë)*,  
*shkul-eshn(ë)* //  
*ngro-h-esh(ë)*, *ngro-h-eshe*, *ngro-h-esh*, *ngro-h-eshm(ë)*,  
*ngro-h-esht(ë)*, *ngro-h-eshn(ë)* //  
*kthen-esh(ë)*, *kthen-eshe*, *kthen-esh*, *kthen-eshm(ë)*,  
*kthen-esht(ë)*, *kthen-eshn(ë)* //

Për vetën e I njëjës përdoret edhe mbaresa *-a* dhe për vetën e III *-ej*, ndërsa për shumësin *-eshim*, *-eshit*, *-eshin*, po janë më të rralla dhe jo të brezit të vjetër e duket që janë ndikime nga gjuha e shkruar, të futura nëpërmjet shkollës, radios etj.

39. Veta e parë njëjës e së kryerës së thjeshtë e foljeve të diatezës pësore, vetvetore e mesore formohet në shumicën dërmuese të rasteve me aorist sigmatik: *u lagçë*, *u hodhçë*; *u ndodhçë*; *u fuçë*, *u bëçë*, *u ankuaç*, *u mblakçë*, *u lodhçë*, *u ngopçë*, *u trëmbçë*, *u preçë*, *u prëçë*, *u trumbu-dhuaç*, *u hutuaç* etj., po rrallë edhe *u patakça*, *u prëva*.

40. Në këtë të folme hasen edhe disa ndajfolje dhe trajta ndajfoljesh me interes, të cilat po i vë në dukje sipas llojeve.

Ndajfolje vendi — *atea* dhe *andea* e *andej*, *këtea* dhe *këndea*. Këto trajtat e dyta përdoren më rrallë: mer gurë *atea* /, hith *andej*, hith *këtea* / etj.

Ndajfolje kohe — *pastaj*, *pastaja*, *pastajna* dhe *pastana*: *pastaj* e *hidhijn* /, *pastaja* vuri ulurimënë /, *pastana* ulem / etj.; *dje* dhe *djethnaj* e cila bashkë me *pastajna*, *pastana* janë karakteristike për të folmen e grave; *ahjere*, *ahjerej* dhe *ahjera*: *ahjera* vdis njeriu së pathënit /, trajtat *atëhere* dhe *atëherej* janë në përdorim në brezin e mesëm e të riun; *nesret*, *nesmet* : *nesret* vejn e mirin /, u ngre *nesmet* /; *njëherejt* : si bëjnë *njëherejt* ato?; *mënjë* «tani»: *mënjë* kren zojtë /.

Ndajfolje sasië — *aqe*, *kaqe* «aqë, kaqë»: *kaqe* sa dora /

Ndajfolje mënyre — *fshehura*

Për t'u vënë në dukje si tipar i përbashkët është përhapja e fundores *-a* në ndajfoljet: *atea*, *këtea*, *ahjera*, *pastaja*, *fshehura* etj. Ndoshta këtu mund të vendoset një lidhje midis përdorimit në emërore (në vend të rasës kallzore) të emrave në konstrukte të tilla si : mbeti pa ngrën tërë *dita* /, një kemi shpurë gjithë *jeta* /, dhe rasteve të mësipërme.

### Fjalëformimi

41. Përsa i përket fjalëformimit do të përmendet këtu ndonjë parashtesë ose prapashtesë që paraqet interes dialektor në krahasim me të folmet e tjera.

Nga parashtesat janë për t'u përmendur parashtesat *sh-* dhe *z-*, të

27) M. Domi, *vep. e cituar*, 75.

cilat në të folmet e tjera paraqiten në trajtën ç-, x-: *shkul, shkrij, shquaj, shkoq, shkrifëroj* etj.; *zgjith, zbruj, zbras, z bath, zbarth* etj.

Mjaft e gjallë është këtu prapashtesa -ël(ë), e cila në Lunxheri, Kurvelesh etj. ka trajtën -ij. Kjo prapashtesë bashkohet me tema foljore (me ato që dalin me temë më bashkëtingëllore) për të dhënë emra që tregojnë veprim ose rezultat veprimi si: *vdekël, rojtëlë, ardhël, vrasëlë, kamëlë, pietël, vjedhël, sëmundëlë, lidhëlë* etj., me tema emërore për të dhënë emra sendesh: *barkël, mesël, sharkël* etj. Me këtë prapashtesë formohen edhe emra mocioni: *Qadhëlë* «gruaja e Qadhos», *Hodelë, Hamzëlë, Sulëlë, Spirëlë, Dhimëlë, Taqël, Çausëlë* etj.

Në këtë të folme bashkëjetojnë prapashtesat -at dhe -anj, me të cilat formohen emra fisesh e familjesh: *Bejkat, Karagjozat, Çelat, Zejkat, Kurtat, Baboçat* (edhe *Baboçanj*), *Shapllanj, Xhikanj, Sinananj, Lazanj, Gjinnanaj* etj. Prapashtesa -at gjendet dhe në emrat e disa lagjeve si: *Dunavat, Dengat, Hazmurat* e *Manalat*. Prapashtesa -at për këtë të folme duket që është më e vjetër, meqë haset dhe në toponomastikë, kurse -anj jo, dhe veç kësaj, siç më ka kumtuar Prof. E. Çabej, emrat me -at tregojnë fisin, ndërsa emrat me -anj tregojnë familje, pra një njisi më të vogël, e cila rrjedh nga ndarja e fisit, pastaj nga sa kam vënë re vetë, emrat me -at tregojnë fise të vjetra të këtij qyteti. Një përdorim të tillë kanë këto prapashtesa edhe në Muzinë.

Në sferën e terminologjisë blegtorale janë produktive prapashtesat -ul e -ush, me të cilat formohen emrat e deshve e të cjepeve nga ata të dhenve e të dhive: *kuacul* nga *kuacë, bejkul, mazhul, siskul, sorkul, vrizul* etj., *bejkush, vakrush, larush, dhajush* «llajush» etj. dhe -ër, me të cilën formohen mbiemra: *i bejkër* nga *bejkë, i shutër, i kurtër, i rudër* etj.

Në mbiemrat që vinë prej foljesh, është përgjithësuar trajta -ët e prapashtesës -të: *i ngrohët, i ftohët, i kdhidhët* «i kthjelltë», *i lodhët, i hapët, i ngordhët* etj.

Për t'u vënë në dukje është edhe prapashtesa -ntë e mbiemrit nga emri «flori»: *i florintë*, e cila në Konispol ka trajtën -mtë: *i florimtë* e në të folme të tjera -njtë: *i florinjtë*.

## KONKLUZION

Ç'vend zë e folmja e Gjirokastrës në grupin e të folmeve të toskërishtes së jugut?

Për të përcaktuar këtë, kjo e folme do të krahasohet me të folmen e Kurveleshit (sidomos me atë të Kurveleshit të Sipërm, meqë kjo ndodhet më afër dhe ka qenë në lidhje të drejtpërdrejta me të) dhe nga ana tjetër me të folmen e Konispolit, të dyja, sipas mendimit tim, më tipiket e të folmeve të toskërishtes jugore. Krahasimi do të bëhet kështu: do të vihen në dukje ato pika ku e folmja e Gjirokastrës afrohet me atë të Konispolit e njëkohësisht dallohet nga ajo e Kurveleshit, e pastaj ato pika ku largohet nga e folmja e Konispolit dhe afrohet me atë të Kurveleshit.

I. Afrime me Konispolin dhe dallime me Kurveleshin.

Fonetikë:

a) Një nga pikat më të rëndësishme, ku e folmja e Gjirokastrës dhe e Kurveleshit afrohen, është mungesa e fonemës *y*. Në vend të kësaj foneme kanë kryesisht *i*, po në disa raste dhe *u*. E folmja e Kurveleshit

të Sipërm e ka fonemën *y*.

b) Si në Gjirokastër dhe në Konispol bashkëtingëllorja *sh* në mbaresat e dëshirores dhe të aoristit sigmatik vepror është ndruar në *ç*: *-fça*, *-fç*, *-fçim*, *-fçi*, *-fçin*; *laçë*, *raçë*, *thaçë*, *paçë* etj. gjë që nuk ndodh në Kurvelesh.

c) Në dy të parat *nj*-ja fundore në shumësin e emrave ruhet: *mudhinj*, *kërcinj*, *thonj*, *Shapllanj*, *Lazanj* etj., kurse në Kurvelesh në shumësin e emrave të tipit *mulli* herë ruhet e herë ndrohet në *j*, ndërsa në emrat patronimikë me *-anj* është ndruar pa përjashtim në *j*: *kushërinj* dhe *kushërij*, *thonj* dhe *thoj*, *Gaxhaj*, *Peçaj* etj.

ç) E folmja e Gjirokastrës afrohet në atë të Konispolit edhe në ruajtjen e një *l*-je të vjetër, që vjen nga një *lj*, si dhe të grupeve bashkëtingëllore *lk* e *lg*: *palë*, *milë*, *ulk*, *balgë* etj., të cilat në Kurvelesh kanë dhënë përkatësisht *j*, *jk*, *yg*.

Ka dhe disa pika të tjera, ku e folmja e Gjirokastrës afrohet pjesërisht me të folmen e Konispolit. Të tilla janë:

a) Kuantiteti i zanoreve të theksuara. Në Gjirokastër nuk ruhen zanore të gjata. Gjatësia është bjerrë edhe në të folmen e Konispolit, po atje jo në një masë të plotë si në atë të Gjirokastrës. Në Kurvelesh gjatësia ruhet mjaft mirë.

b) E folmja e Gjirokastrës nuk afrohet plotësisht me të folmen e Konispolit edhe për sa i përket fatit të grupeve bashkëtingëllore *mb*, *nd*, *ng*, *ngj*. Siç është bërë e qartë, këto ruhen në të folmen e Gjirokastrës, po kanë filluar të zhvillohen në Konispol në mënyrë të tillë, që okluzivi asimilon bashkëtingëlloren hundore, pra në *b,d,g,gj*, kështu që sot ndihen krahas, po me dallime midis bazash, trajtat e reduktuara të këtyre grupeve me trajtat e reduktuara. Në Kurvelesh këto grupe janë asimiluar plotësisht, po me rrugë zhvillimi të kundërt me atë të së folmes së Kurveleshit, sepse këtu okluzivi është asimiluar prej hundores duke dhënë kështu: *m*, *n* e *n̄*, *n* dhe *nj*.

Morfologji:

a) Në këtë sferë e folmja e Gjirokastrës dhe e Konispolit afrohen në formimin e trajtave të shumësit të së tashmes, veta e I dhe e III. Këto formohen me anë të mbaresave: v. I *-im*, III *-in* dhe v. I *-ëm*, III *-ën*. Në Kurvelesh të Sipërm hasen vetëm mbaresat v. I *-ëm*, III *-ën*.

b) Si në të folmen e Gjirokastrës ashtu dhe në atë të Konispolit në vetën e I njëjës të së pakryerës për foljet me bashkëtingëllore është shtrirë analogjikisht mbaresa e foljeve të zgjedhimit të III, para së cilës ka dalë zanorja *i*. Po në Konispol kjo mbaresë e re ende nuk e ka zëvendësuar plotësisht mbaresën e vjetër *-ë*, e cila është e vetmja në Kurvelesh të Sipërm. Gjithashtu në shumës po të këtyre foljeve krahas mbaresave *-ëm*, *-ët*, *-ën*, që janë të vetmet në Kurvelesh të Sipërm, përdoren më rrallë edhe mbaresat *-im*, *-it*, *-in*, të cilat nga ana tjetër janë më të përdorshmet në Gjirokastër.

c) Të folmet e Gjirokastrës dhe të Konispolit i afron edhe përdorimi i prapashtesës *-at*, që formon emra patronimikë. Kjo prapashtesë nuk përdoret në Kurvelesh. Gjithashtu e afrojnë me të folmen e Konispolit parashtesat *sh-* e *z-*: *shkul*, *shkoq*, *zbath* etj., të cilat në Kurvelesh kanë trajtat *ç-* e *x-*: *çkul*, *çkoq*, *xbath* etj.

## II. Dallime me Konispolin dhe afrime me Kurveleshin.

Fonetikë.

a) Fati i *u*-së paratheksore është një nga pikat që i dallon të folmet

e Gjirokastrës nga e Konispolit. Kjo *u* është bërë *ë*, e cila shpesh ka rënë, në të folmen e Konispolit: *këptoj*, *zbløj*, po është ruajtur në Gjirokastrë ashtu si dhe në Kurvelesh.

b) Në të folmen e Konispolit togu zanor *ua* në pozicione fonetike të caktuara, sidomos para *j*-së, ndrohet në *ue*, fenomen që nuk vrehet as në Gjirokastrë as në Kurvelesh.

c) Edhe zhvillimi *ie* në *e* (psh. *sell*, *shpere*, *çerr* etj.) në të folmen e Konispolit e dallon këtë nga e folmja e Gjirokastrës dhe e afron me atë të Kurveleshit.

ç) Në të pakryerën e foljeve si në njëjës dhe në shumës bashkëtingëllojja *nj* në Konispol është ruajtur; por në të folmen e Gjirokastrës si edhe në atë të Kurveleshit është ndruar në *j*.

d) Grupet *kl* e *gl* të cilët ruhen në Konispol, janë palatalizuar në *q* e *gj* në Gjirokastrë e Kurvelesh.

Morfologji.

a) Veta e III e së pakryerës njëjës del në Konispol edhe me mbare-sën *-ej*, e cila nuk ndeshet as në të folmen e Gjirokastrës, as në atë të Kurveleshit.

b) Mbaresat e së pakryerës shumës të diatezës pësore etj. në të folmen e Gjirokastrës dhe të Kurveleshit janë: I *-eshm(ë)*, II *-esht(ë)*, III *-eshn(ë)*, kurse në Konispol: I *-eshim*, II *-eshit*, III *-eshin*.

c) E folmja e Gjirokastrës dallohet nga ajo e Konispolit e afrohet me të folmen e Kurveleshit edhe në formimin e kohëve të përbëra të foljeve të diatezës pësore etj., të cilat në të parën formohen me anë të foljes ndihmtare «jam» (*jam lodhur*), kurse në Konispol formohen nga trajtat përkatëse të diatezës veprorë, të cilave u paravijet pjesëza *u* (psh. *u kam lodhur*).

Nga ky krahasim del se e folmja e Gjirokastrës afrohet më tepër me atë të Konispolit. Këto dallohen midis tyre kryesisht në ato inovacione të njerës e tjetrës, që i përkasin një periode të vonë të tyre. Po, duke qenë nga territori shumë afër me Kurveleshin e Sipërm, e folmja e Gjirokastrës ka tipare që e afrojnë edhe me atë. Sipas ndarjes së deritanishme dialektore e folmja e Gjirokastrës është përfshirë në nëndialektin lab. Tani kjo gjë mua s'po më duket fort e drejtë, megjithëse nga pikpamja etnografike, siç është theksuar edhe në hyrje, Gjirokastra bën pjesë në krahinën e Labërisë. Nga ana tjetër nuk mund të thuhet që duhet përfshirë në nëndialektin çam. Mendimi im është që ndarja e sotme e të folmeve të toskërishtes, sidomos jugore, ka më tepër bazë etnografike. Sa rezulton nga materialet që janë mbledhur në këto anë, ndarja etnografike nuk është identike me atë dialektore. Për të patur një ide më të qartë për të folmet e kësaj treve, një grupim i ri i këtyre të folmeve është i domosdoshëm, po për një gjë të tillë këtu nuk është vendi, prandaj dhe përcaktimi i pozitës dialektore të së folmes së Gjirokastrës do të mbetet i vagët.

## TEKSTE

— 1 —

Ish mos kish!

Qe një nënë / kish një djalë // u rit ai djali / i tha nënës: «o vete në gurbet / më jep pesë napolona!» dhe u nis vate / dodhi // vate mu në mes t'udhës / gjeti një burë / kren një të vdekur na vari ai buri // i thot ai djali: «ç bën kështu?» — i thotë //

— «Krej këtë të vdekur na vari / se më ka marë pesë napolon kur  
qe gjadhë // tani e krej mbi dhe ta hanë korbat» //

— Dhe ai i thotë: «gjina / mos e kre! na këto pesë napolon e na vari  
mos e kre / se është gjunah» //

I mori parat ai buri dhe iku // ki u kdhie prapë / vate te nëna //

— I thotë: «nam edhe pesë napolon të tjera / se s më dalën ato pesë  
napolon që më dhe!»

Dhe ai u nis dhe vate atje te vari // e gjeti të vdekurin e rin në bith //  
qe ngritur na vari // ku je nisur? — i thotë së gjadhë //

— «Jam nisur në gurbet për kismet // shkova filan ditë këtu te ki  
vari / gjeta një burë / kren një të vdekur na vari // dhe u i thaçë: ç bën  
kështu? pse e kren këtea? — më kish marë pesë napolon kur qe gjadhë» //

— Bënemi vëdhamë bashkë / vemi në kseniti? — i thot ai //

U nisnë // dhe i tha ai: «pa pjetur njeri tjetrin mos bëjmë hiç pu-  
në» // dhe vanë në han të flinjë // i thot ai hanxhiu: «këtu mos eni të  
flini / se këtu është një arap edhe ju pret kokën // dhe u / i zoti / vete  
flë në shtëpi» //

— «Mir / i thotë ai i vdekuri / le t na e marë / o të flëmë këtu» //

Ju dha hapsë dhe iku hanxhiu në shtëpi // ranë për gjumë // ai i  
gjadhë fjeti / ai i vdekuri nukë fjeti // një t dalë arapi t u mir kokën //  
ja preu ai / dhe një të ngritur ai i vdekuri këceu n atë bimsën e atij arapit  
dhe mori atje lira e flori që jau kish marë popudhit // mer ki i vdekuri  
dizet napolon dhe ja vë në xhep të sahatit / që flin // u gdhi sabau / u  
pataks ai i zoti hanit q i gjeti këta të gjadhë // duadhnë në pazar të  
di // »o vëdham / qerasi këta shokët në kafene!»

— U nguq na surati ai // «me se t i qeras?!»

— i thot ai i vdekuri: «në xhep të sahatit i ke / meri!»

U shkriërua ai / gëzoj / i qerasi ata shokët // duadhnë na kafenea //  
muar vesh që mbreti kish pohtisur një vajzë / e kish pesmbet vjeç /  
vuvë / pa golë // kish vënë telalë mbreti: «kush ta bëjë vajzën time të  
flasijë / ta marë grua» //

— «E bëj u» / tha djali // «u!u! xh bëra! u ndodhçë bosh që s pjeta  
vëdhamë» //

Vate dhe ai i thot: «bëra një fal / i thotë / kështu kështu» //

— «S ka gjë» / i thotë //

Vate ainë te mbreti dhe hiri brënda // dhe ai i vdekuri u bë erë e  
vate hiri në musandara // dha e mori ai / dha e mori ta bën të flit / ao  
s flit // pastaj i thotë: «hej hej / moj musandara / më hodhi sevdaja te  
kjo bil e mbretit!... po pse s më flet? o t më heqin kokën» //

— «Qenë tre vëdhezër / i thotë musandaraja / u vdiq babaj / u la  
një vështë // dhe ata u ndanë // qe një rënjë erdhi e tepër / anameso //  
vate i madhi ta nduk / s e kreu dot // vate i mesmi / s e kreu dot // vate  
i vogëli / e kreu // çili qe m i fortë?»

— «I vogëli» / tha kjo vajza

— «Fole» / i tha ai //

— «Fola me musandaranë / s fola me njeri» //

E fitojti ai // vanë te mbreti // «kur të të thotë mbreti «zh do na  
mua të të bëj» / mos kërkë gjë / po nëntëdhjet e tre kafshë e nëntëdhjet  
sënduqe» / i thotë i vdekuri //

Ashtu bëri //

— «Ç janë këto që thua?» i thotë mbreti //

— «Këto dua» //

Mbreti q atë kohë ja bëri // e mori dhe ai vajzën dhe kafshët e ven tek ai hani // kre flori e mbush sënduqet me lopatë // i ngarkojti dhe iknë // erdhi mu tek ai vari // «o vëdham / i thotë ai i vdekuri / pa këce na kafsha / xërmo!» dhe ata kërcien // «tani këtë gruan o ta ndajmë bashkë» //

— «Po!» i thotë i gjadhi //

Na zum ta pritin / ajo kreu një gjarpër na gola // «na / i thot ai / të qoftë / është tëndja // po dëgjo këtu / vëdha / u o të t dërgoj një kono e të viç këtu tek mua e të thuaç: hapu o bumbareq!»

Mori gruan ai dhe kafshët dhe iku // vate në shtëpi // i bëri shtëpitë si të mbretit // për ca kohë i vete ainë / konua // e përzuri plaka / se i fëdhiq / i njgjesh shtëpinë // «le mos i folë / nënë / se ao kono më bëri kështu» //

Edhe ki u ngre vate pas konos // vate te vari // «hapu u bumbareq!» u hap dhe hiri brënda dhe u mbidh prapë // kur hiri brënda / u poq me të // «po këta zudhapër që ke këtu / ç janë këta?» i tha ai djali //

— «Kjo shtë gruaja / kjo shtë nëna» //

— «Pse janë kështu?» i tha //

— I tha ki shoku: «ashtu e kishnë zëmrënë / ashtu i bëri zoti / zudhapër» //

— «Pse s i lute zotit të bëhen dhe këta si ti?»

Dhe ai u lut / u bënë isanë // të dia me një golë: «pupu! le n atë dinja bije miq e shokë / po edhe në këtë dinja prapë shokë?»

— «Sheh / mo vëdham? e kanë zëmëren të ligë» //

U bënë prapë zudhapër //

U mblakn e u trashëguan //

E tregoi: Elma Rusto

— 2 —

Ish mos kish!

Qe një mbret kish tre vashaz // dhe erdhi koha të vin në sefer / për luftë domethënë // u thotë vashaze: «z vete dot / moj vashaz / se ju kam ju» //

— «Pse të mos veç?» i thonë vashazt //

— «Naha ju / se ju kam vashaz të ritura e më bëni nonjë turp» //

— «Hajde / baba / një t u nxiftë kondoja në kraha / më bie lera mua» / i tha e madhia //

Ajo bëri bashto // ju nxi kondoja në kraha //

— I thot e mesmia: «një mos të bëftë vështi rush / o të vë lerë u» //

Dhe bashto bëri // të di vashazt e mbëdha //

— I thot e vogëla: «një mbefte kroj pa ujë / o t vë lerë u» //

Kroj po bin //

«O vete në shtëpi» / tha mbreti //

E dëgjuan vashazt që do vin babaj në shtëpi / dhe çajtin e ndajtin / gjenë një gjarpër / e vranë / e hodhnë në bucel // hodhnë dhe gjak në bucelë // i thonë: «kërko ujë andej /» e pijti gjarpërin në bark //

Erdhi babaj në shtëpi / e pritën dhe babanë / e gëzuan // u thotë babaj: «pa eni këtu / moj vashaz / qasuni këtu pranë / «i thotë së madhes: «më the një t u nxiftë këmisha në kraha / këmisha m u nxi» // «vështi s më bëri rush» / i thotë së mesmes // «më tha një të shtërpofte kroj / kroj po bie» //

— «Të shoç barkun se kush e ka të madh» //

E vogëla e kish të madh se kish gjarpërin në bark / që pijti // e babaj o ta përzin / o ta bën surgjun // «mos më mer në qafë / i tha / se u s kam gjë» / i tha //

Edhe kjo iku // vate u fut te një prua në gufë // atje te ao / te mali genë tre çobenj me dhëntë dhe kjo vajza ven u bën kulaçin / qudhin e qenit // thoshnë këta «kush na e bën këtë bukë e qudhin e qenit?» / se u a bën fshehura // «o ta përgjojmë» //

E përgjuan dhe e zunë / i treti vëdha // «ç je ti / i tha / njeri je a shejtan?»

— «Njeri jam / i tha / jam e bil e mbretit / po më ka përzënë babaj» / i tha //

— «Pse të ka përzënë?»

— «Se mendon se mos jeshë me barë» //

Dhe ata muar një kusi me qumusht dhe e vunë në zjar // edhe e muarnë këtë vajzën e varnë kokëposhtë // «hape golën tani / i thanë / të vejë avudhi qumushtit» // edhe kjo hapi golën dhe i ra gjarpëri në kusin me qumusht //

Ai çobani q e zuri këtë / e mori grua // Këta kishnë motrën pranë mbretit / vate mik te kjo vajza // mbreti ulërin që i dhim faqia / që ipin mileti që hajnë mane / se kur iku kjo / e nëmi babanë: i tha: «të daltë një man në faqe / t ipçin gjithë bota të hanë» //

«Ç është ki që bën kështu?».

— «Është mbreti / e ka nëmur vajza» //

— «Vem ta shohim një çik» / i thot ajo vajzës //

Edhe ajo vete atje / e pa me man në faqe babanë // «të të thom një pradhë?» i thotë mbretit //

— «Thuam / moj bilë»

Don t i bin atë të sajnë / që s kish gjë // ja tha pradhën // kër mani na rënjat / e «u jam bila tënde» / i tha //

— Eni këtu / moj vashaz / «u tha vashazet // «kuelt e halmëshuara doni apo thikët e pikët?»

— «Thikët e pikët qofçin në derë të hasmit» //

Një të lidhur na bisht e kuele dhe i bëri copa copa //

E tregoi: Elma Rusto

— 3 —

Na qe një burë / na kishte një qën / po ai ishte si i pashtuar // ai i thotë gruas: «shi se ç do bëj / do mar qënin me vete në pazar dhe ti të bëç një supë dhe një birek / se u do bie një shok për drekë / i thotë // po unë do bëj sikur o t dërgoj qenin / sikur të thotë / ti do bëç këto» //

Edhe ki vete në pazar // i thotë atij shokut: «do viç për drekë» //

— «Ku do më shpieç?»

— «Unë do dërgoj qenin» // i thotë qenit: «shkon në shtëpi edhe thuaq në shtëpi që do bëç një supë dhe birek / se unë o bie një shok për drekë» //

Qeni vate ashtu në shtëpi // venë dhe ata në shtëpi në drekë / adetet // i kreu drekën // pa ai ato gjedhëra q i tha ai atje // hangrën / pijtën dhe i tha: «do ma sheç mua këtë qenin» //

— «Jo s ta shes» / i thosh //

E dha njëzet napolon // ki e mori qenin dhe i thotë një mikut: «do më viç sot për drek» i thotë //

— «Jo» / i thot ai //

— «Dom viç / i thotë / se unë kam qenin / vete në shtëpi t i thotë gruas» // i thotë qenit: «ikë në shtëpi dhe thuaj të bëjnë birek / mish me patate se o bie një mik» // i ra qenit me shqelm //

Mer dhe ki mikun dhe e shpie në shtëpi / vete te gruaja // «misertë» / gruaja / e priti atë // i thotë gruas: «I ke bënë / se kam prurë shokun për drekë?»

— «Po pse me se më dërgove habër?»

— «Të dërgova me qenin» //

— «Po pse qeni. . .» //

Mbeti ki u turpërua // «qerataj! po pse ti nuk të tha qeni? do vete të zirem me të» //

U nis ki dhe vate te shoku // «more / më tërpërove te shoku»

— «Ku di ti» / i thotë // «kam edhe gomarin që bën napolona» //

— «Do ma sheç mua / të ta ble u» //

Se sa ja shiti dhe gomarinë // e bleu / e mori gomarin // «po do ta ushqej mirë sontë» / i thotë / dhe ki vate në shtëpi / e mbidh në katoq // gomari ha grurë e pi ujë / ngordhi gomari // i feksin potkonjtë e këmbëve // ki u ngre në mëngjes / i thotë: «moj grua / na ka bënë» // kur vate gjen gomarin të ngordhët // «i do t i bëj një gjë / i do ta vras / më qeshi» //

Edhe t i ngriet e vete // «hape portën / e hapi / vate brënda // «më qeshe» / i tha // po ki u kish thënë gruas e fëmilës: «unë do bëj sikur t u ther // kur t i bie cules juve të ngriheni» // i theri //

— «Çbëre?» i tha //

— «I ngjadh prap / i thotë / i frij xamares» //

— «Do ma sheç mua këtë xamare» //

— «S ta jap / i tha / se nukë di ti» //

Ja dha ai / e bleu / vate në shtëpi / një t i therur gruan e fëmilën që t i ngjadhte // fri xamares / sh t i ngjadheshin! i varosi fëmilën // «ç më bëre! u kam për të mbitur // o të të hedh në lumë / o të të mbit / s të lë» //

E mori e futi në një zhakë / e lidhi dhe zhakën edhe e mer ta hidhte në lumë // iku e iku që të vente në lumë // atje qe një çoban që ruante bagëtinë // e la atje në shesh / u lodh / iku më tej // i thot ai çobani: «të riç me këto dhëntë!»

— «Xidhëm zhakën!»

Ki një të xidhur zhakën / e hodhi dhabanen e vete singur qe ai // erdhi e mori xhakën dhe e hodhi në lumë bédumb // u kdhie shoku tia edhe atë kohë xbuloj dhabanën / panden se qe ai brënda // «shi ç kërkova unë! të më keshe shturë në mes o keshe krier më shumë» //

— Vjen më shtie dhe mua?»

E mer e vete e shtie dhe na u mblakn e trashëguan //

E tregoi Melpo Zëra

## Tregues fjalësh të vështira

- adhonár-i*, korrik  
*anamésó* ndf., në mes  
*bardhëremë (e) (i,e)*, i zbardhur.  
*bárkël (ë)*, -a, rrypi me të cilin lidhin fëmijën në djep.  
*báshto-uz*, fëmijë jo i ligjshëm.  
*béjkë-a* (m. -ul), dele e bardhë.  
*bez-i*, -e, rrobë që shtrohej nën sufër.  
*bexhék-u*, -e, insekt që ha rrënjët e domateve, pipereve etj., bushtërzë.  
*bilúr-i*, -e, bërrul.  
*bod-i*, -e, shtambë.  
*bragác-i*, -e, dorje.  
*buján-i*, -e, pellg.  
*cak-u*, caqe, dhokan.  
*cakúre-ia*, sëpatë e vogël.  
*cep-i*, -a, sqep.  
*cimbídh-i*, -e, 1. darë, 2. mashë, 3. trari anësor i çatisë.  
*cínxër-i*, -ë, gjinkallë.  
*çallëstís* f., përpiqem të arrij, të rregulloj diçka.  
*daján-i*, -e, trari vertikal i çatisë, baballëk.  
*destemél-i*, -e, shami koke.  
*dhabáne-ia*, llabane.  
*dhájë-a* (m. -ush), dhi e zezë, llajë.  
*dhápë-a* (m. -ush), dele me veshë të mëdhej, llapë.  
*erësilë-a*, erësirë.  
*fcúrk-u*, *fcurqe*, cfurk, akrep.  
*f dháckë-a*, fllackë, pllockë.  
*feks* f., ndrij.  
*fitúa-fitoj*, *fitonj*, fidan.  
*frastúa-frastoj*, *frastonj*, mblatës.  
*grumbudhóre-ja*, diçka e rrumbullaktë, si topth.  
*gúfë-a*, guvë.  
*gjírmë-a*, vatër.  
*hamulít* (qeni), bën ham ham, leh.  
*hamurík-u*, -a, urith.  
*hujá* sh., hoje.  
*hjetónem* f., shkalem.  
*hjetúar* (i, e), i shkalur.  
*jongár-i*, -ë, lloj fyelli në formë bige, i cili ka në çdo degë të bigës nga tri vrime.  
*juk-u*, juqe, stavë rrobash.  
*kabádhë-a* (m. -ul), dhi gjysmë e bardhë gjysmë e zezë.  
*kalíqe-ia*, nallane.  
*kalístir-i*, -e, capë.  
*kámëlë-a*, kamje.  
*kataráh-u*, -e, shuli i portës a i derës.  
*këshllá* sh., shtëpi të mëdha.  
*kókadh-i*, kokall, kockë.  
*kondó-ja*, këmishë me mëngë të shkurtëra e me kinda.  
*kóno-ua*, kone.  
*krej* f., nxjerr.  
*kroç-i*, -ër (f. *kroçe-ia*), kërric.

- kronjgjidh-i*, kongjill.  
*krut-i*, -ër, dash me brirë të vegjël.  
*krútë-a*, dele me brirë.  
*ksenití-a*, kurbet.  
*kuacë-a* (m. *kuac-i*, -ër, dhe *kuacul*), dele me surrat të kuq.  
*kucokrút-i*, -ër, dash me brirë shumë të vegjël, që u a heqin, se u kthehen e u futen në mish.  
*kulísh-i*, -ër, këlysh.  
*langór-i*, -ë, qen gjahu.  
*lidhëlë-a*, lidhje.  
*makát-i*, -e, rrobë që shtrohet mbi minder.  
*mázhë-a* (m. -ul), dele me surrat të zi.  
*mésël-a*, qilim.  
*mezár-i*, -e, varr.  
*mumulígë-a*, mëmëligë.  
*musandará-ja*, musandër.  
*mustúk-u*, sterë.  
*nduk* f., tërheq, çqyej.  
*njggjácur* (i,e), i zgjatur.  
*njggjishem* f., fëlliqem.  
*pietël-a*, pyetje.  
*pirí-u*, *shm*, dru i vogël, që mban të bashkuar hekurat me sirtin e par-mendës.  
*plásël-a*, plasje.  
*potís* f., vadit.  
*pohtís*, f., lind, pjell.  
*qíngël-i*, -a, nënbarkëz.  
*sandrác-i*, -ë, vegël e nallbanëve, që përdoret për të prerë thonjtë e kafshëve që mbathen.  
*sinjgjení-a*, farefisi.  
*sískë-a* (m. -ul), dele që ka një rryp të zi anës faqeve.  
*sórkë-a* (m. -ul), dele me faqe të zeza e hundë të bardhë.  
*spithár-i*, -ë, gropë në një shkëmb, që mbledh ujë.  
*spreth-i*, -e, strehë.  
*shárkël-a*, brucë, po me flokë shumë të rrallë.  
*shéshël-a*, pantofla.  
*shídhá* (pjesëz), ja: «shidha erdhë kulishtë.»  
*shtírës-i*, shkop në formë, T-je, me të cilin shtyjnë bagëtinë drejt syrit të shtrungës.  
*shut-i*, -ër, dash pa brirë.  
*vrízë-a* (m. -ul), dele me surrat si në kafe.  
*vúvë-a*, memece.  
*xamáre-ja*, fyell.  
*xërmój* f., zbres.  
*zagoréc-i*, -ë, dru i vogël që mban tevluku në zgjedhë.  
*záhar-i*, sheqer.  
*zbórë-a*, dëborë.  
*zburdhúlem* f., zbardhem.  
*zudháp-i*, *zudhepër*, zullap.  
*zhákë-a*, thes.

## R é s u m é

## OBSERVATIONS SUR LE PARLER DE GJIROKASTËR

Dans son exposé, l'auteur décrit, et, dans quelques cas, explique les phénomènes les plus caractéristiques de la phonétique et de la morphologie du parler de la ville de Gjirokastër. Une des villes les plus anciennes de l'Albanie méridionale au point de vue de l'ethnographie Gjirokastër est comprise dans la région de la Labëri et a été le chef-lieu économique de sa partie du S.-E. Au point de vue du langage, Gjirokastër attire l'attention pour toute une suite de traits originaux qui le font distinguer de parlers qui l'entourent.

En phonétique, on peut distinguer: 1) la conservation de l'*ë* final non seulement chez les mots paroxytons, mais aussi chez les proparoxytons: *bukë*, *shtëpisë*, *núsenë*, etc.; 2) l'absence du phonème *y*, auquel on a substitué *i* ou *u*: *si*, *di*, *hij*, *bilur* «bërryl», *qutet*, *ature* à côté d'*atire*, *gjim*, *mifti*, *burazër*, *çurek*, etc.; 3) l'absence de la vibrante *rr* et sa substitution par la vibrante *r*: *mar*, *naxjer*, etc.; 4) le passage du *ll* en *dh*: *dhambë* «llambë», *diedhi* «dielli», *madhëkoj* «mallëkoj», *miedh* «miell», etc. (A ce propos l'auteur a constaté que le phénomène contraire, c'est-à-dire le passage du *dh* en *ll*, est inexistant dans le langage de la génération ancienne et moyenne non-scolarisée. Les cas sporadiques de passage du *dh* : *ll*, qu'on remarque chez les jeunes, et, en général, chez les scolarisés, représentent plutôt des confusions issues de la tendance à prononcer le phonème *ll*, inexistant dans ce parler. Cette tendance, à l'état actuel de ce parler, ne constitue pas un phénomène dialectal); 5) la conservation d'un *l* palatal ancien et des groupes *lk* et *lg* dans des mots du genre: *bilë* «bijë», *malë* «majë», *val* «vaj», *ulk* «ujk», *balgë* «bajgë», etc.; 6) l'absence d'assourdissement des consonnes sonores à la fin et au milieu du mot devant une consonne sonore.

En morphologie on a: 1) La persistance de la désinence *-e* dans la formation du pluriel des noms masculins indiquant des objets, et ce partant la modification du genre de ces noms au pluriel: *puse të thedha*, *samare të prishura*, *koshtëre të mbëdha*, etc.; 2) la généralisation de l'article préposé féminin *së* dans tous les cas d'usage de l'article *të*: *suratit së foshnjës /, i thotë së gjadhit /, u thotë së tërave /, në të vashazet së tu /*, etc.; 3) la simplification des formes de l'adjectif possessif à travers la généralisation de la forme de l'accusatif; 4) l'usage de quelques désinences parallèles à l'imparfait, ex. I<sup>re</sup> personne: *-ë*, *-a*, *-jë*, *-ja*, *-ij*, *-ija*; 5) la grande extension de la désinence *-jti* à la troisième personne singulier du passé simple des verbes ayant le thème en voyelle: *shko-jti*, *puno-jti*, *la-jti*, etc.; 6) l'usage à l'optatif des désinences: I<sup>re</sup> personne *-(f)ça*, II<sup>e</sup> *-(f)ç*, III<sup>e</sup> *-(f)të*, pluriel I<sup>re</sup> personne *-(f)çim*, II<sup>e</sup> *-(f)çi*, III<sup>e</sup> *-(f)çin*; 7) l'usage à l'imparfait des verbes de la diathèse passive etc. des terminaisons: I<sup>re</sup> personne *-esh(ë)*, II<sup>e</sup> *-eshe*, III<sup>e</sup> *-esh*; pluriel I<sup>re</sup> personne: *-eshm(ë)*, II<sup>e</sup> *-eshn(ë)*, III<sup>e</sup> *-eshn(ë)*.

Etant donné qu'il s'agit du parler d'une ville, l'auteur a voulu connaître la plupart de ces phénomènes en les comparant avec les parlers des petites régions qui l'entourent. Considéré sous ce point de vue, l'exposé en question dépasse les limites de ce parler. Dans quelques cas, la description et la comparaison des phénomènes est suivie par leur explication. Ainsi, l'auteur a voulu expliquer les causes de la chute, dans quelques positions données, de l'*ë* inaccentué.

Il croit que le reflet de deux façons de l'*ü* turc dans ce parler a affaire au fait que ce mot a été emprunté soit à travers la langue parlée, soit celle écrite: chez les mots empruntés à travers la langue parlée, l'*ü* a donné *i*; chez ceux empruntés à travers la langue écrite, il a donné *u*, à la suite de l'influence de sa graphie, étant donné que *ü u*, *ö o* sont reproduits par le même signe en turc.

Le passage du *nj* en *j* dans les terminaisons des verbes, qui a lieu non seulement dans ce parler mais également dans plusieurs autres, est considéré par l'auteur comme le résultat d'une dissimilation produite à la I<sup>re</sup> et à la III<sup>e</sup> personne du pluriel du présent. Dans ce cas, après la chute de l'*ë* furent formés les groupes consonnantiques *-njm* et *-njn* difficiles à être pronocés. C'est en partant de ce phénomène que ce passage a été généralisé aussi dans d'autres cas, sur la base de l'analogie. L'auteur a fait une tentative à expliquer également quelques formes du système verbal de ce parler.

A la fin de l'exposé ci-contre, l'auteur analyse la place qu'a ce parler par rapport aux autres parlers. Il est d'avis que le parler de Gjirokastër ne peut pas être appelé un parler de la Laberi. Il se situe à un plus grand voisinage des parlers méridionaux de cette région plus voisin au parler de Konispol qu'à ceux plus au nord, comme ce serait p. ex. le parler du Kurvelesh supérieur. Mais, de cela on ne peut affirmer non plus que ce parler soit compris dans le sous-dialecte de la Çamëri.

L'auteur est d'avis que la division présente des parlers du dialecte tosqe, notamment méridionaux, a une base ethnographique plus solide. De ce qu'il résulte des matériaux réunis dans ces régions, la division ethnographique n'est pas identique à celle dialectale, c'est pourquoi il est absolument nécessaire d'effectuer un groupement de ces parlers.

